



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 172**

**dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 116/2012 datë 13.12.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, të ndryshuar..... 10279
Ligj nr. 117/2012 datë 13.12.2012	Për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes ..... 10281
Ligj nr. 118/2012 datë 13.12.2012	Për transportin e mallrave të rrezikshme ..... 10303
Vendim i Kuvendit nr. 50/2012, datë 7.12.2012	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011”.... 10332
Vendim i Kuvendit nr. 51/2012, datë 13.12.2012	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 99, datë 26.5.2011 “Për ngritjen e nënkomisionit për çështjet gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë” ..... 10332
Vendim i Kuvendit nr. 52/2012, datë 13.12.2012	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar ..... 10333
Vendim i Kuvendit nr. 53/2012, datë 20.12.2012	Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për hetimin e veprimtarisë së organeve shtetërore mbi lëvizjen e popullsisë në disa njësi vendore të qarkut të Kukësit gjatë periudhës qershor-nëntor 2012” ..... 10333

Vendim i Kuvendit nr. 54/2012, datë 20.12.2012	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) .....	10334
Udhëzim i ILDKPKI nr. 622, datë 30.11.2012	Për ngritjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave .....	10335

**LIGJ**  
**Nr. 116/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9157, DATË 4.12.2003 “PËR  
PËRGJIMIN E TELEKOMUNIKIMEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:  
“PËR PËRGJIMIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Sipërmarrës i komunikimeve elektronike” është çdo person fizik ose juridik, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Komunikim” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

**Neni 3**

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 10**

**Përmbajtja e vendimit për përgjim**

Vendimi për përgjim përmban këto elemente:

a) institucionin kërkues;

b) strukturën përgjegjëse në SHISH, në seksionin e përgjimeve të Policisë së Shtetit apo në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme ose, sipas rastit, punonjësit e autorizuar nga titullarët e institucioneve kërkuese për të kryer procesin teknik të përgjimit;

c) gjenealitetet dhe adresën e subjektit që do të vendoset nën përgjim ose në ndjekje, mjedisin/mjediset e identifikuara, për të cilat do të kryhet përgjimi, pajisjet fundore që përdor subjekti i përgjimit për realizimin e komunikimit elektronik, si dhe sipërmarrësin e komunikimeve elektronike që ofron shërbimin;



ç) afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit.

Vendimi ngarkon me zbatimin e tij strukturën përgjegjëse të përgjimeve në SHISH dhe institucionin kërkues.”.

#### Neni 4

Në nenin 12, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për llogari të institucioneve të tjera, procesi teknik i përgjimit kryhet nga punonjësit e autorizuar prej tyre.”.

#### Neni 5

Në nenin 13, pas fjalëve “në administrim” shtohen fjalët “dhe e instaluar”.

#### Neni 6

Në nenin 20 pika 3 dhe në përmbajtjen e të gjithë ligjit, pas fjalëve “Ministri i Brendshëm” shtohen fjalët “Ministri i Drejtësisë”.

#### Neni 7

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike realizojnë, me shpenzimet e tyre, infrastrukturën e nevojshme në rrjetin e tyre të komunikimeve elektronike, deri në pikën e lidhjes me bërthamën elektronike të komandimit, për të siguruar, brenda 180 ditëve nga marrja e kërkesës nga institucionet që administrojnë sisteme përgjimi, sipas këtij ligji, aftësinë përgjuese ndaj përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara prej tyre.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kur sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bëjnë çdo lloj ndryshimi teknologjik ose zgjerim kapaciteti, detyrohen të mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit të procesit të përgjimit.”.

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“5. Në rast ndryshimesh në bërthamën elektronike të komandimit, që imponojnë ndryshime në infrastrukturën e komunikimeve elektronike të sipërmarrësve, struktura përgjegjëse për bërthamën elektronike të komandimit njofton sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për ndryshimin, të paktën, 180 ditë para këtij ndryshimi.

6. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit, sipas pikës 1 të këtij neni, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare vepron në përputhje me kompetencat e parashikuara në nenet 18, 131 dhe 137 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

#### Neni 8

Në nenin 24 rreshti i parë, fjalët “në bashkëpunim” zëvendësohen me fjalët “nxjerr një udhëzim të përbashkët” dhe në rreshtin e dytë, fjala “përcaktojnë” zëvendësohet me fjalën “për”.

Neni 9

1. Kudo në ligj fjalët “telekomunikacion” dhe “telekomunikim” zëvendësohen me fjalët “komunikim elektronik”.

2. Kudo në ligj fjalët “Sektori i përgjimeve në SHISH” zëvendësohen me fjalët “Struktura Përgjegjëse e Përgjimeve në SHISH”.

3. Kudo në ligj fjalët “operator/ët e telekomunikacioneve” zëvendësohen me fjalët “sipërmarrës/it e komunikimeve elektronike”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7874, datë 26.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 117/2012**

**PËR AGJENCINË E INTELIGJENCËS SË MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, rregullon pozitën juridike, administrative, karrierën, si dhe përcakton të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit të kësaj agjencie.

**Neni 2  
Fusha e zbatimit të ligjit**

1. Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, sipas zonave të përgjegjësisë dhe zonave të interesit nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. Veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përfshin çështje që lidhen me kërcënimet ndaj misionit kushtetues të Forcave të Armatosura dhe veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes.



3. Veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ushtrohet mbi subjekte ushtarake, civile, vendase, të huaja, me ose pa shtetësi, rezidente ose jo në Republikën e Shqipërisë, të cilat synojnë të cenojnë apo cenojnë misionin kushtetues të Forcave të Armatosura dhe veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes

### Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes” është shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që ka arsimin dhe kualifikimin përkatës, sipas kriterëve të këtij ligji dhe që punon në strukturat e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. “Inteligjencë” është procesi, gjatë të cilit kryhen grumbullimi, përpunimi, analizimi, vlerësimi dhe shpërndarja e produktit të veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

3. “Kundërinteligjencë” është veprimtaria që merret me identifikimin e rreziqeve ndaj misionit kushtetues të Forcave të Armatosura dhe veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kundërveprimin ndaj tyre, të cilat vijnë nga shërbime të huaja të inteligjencës, organizata ose individë të përfshirë në spiunazh, sabotazh, subversion, terrorizëm ose krimin e organizuar.

4. “Qendër inteligjence” është një strukturë/njësi e përkohshme, që krijohet dhe funksionon jashtë vendit dhe ka për qëllim të grumbullojë informacion inteligjence dhe sigurie në interes të përmbushjes së misionit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

5. “Zonë përgjegjësie” është hapësira gjeografike e përcaktuar për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes, në të cilën agjencia është përgjegjëse për grumbullim informacioni dhe prodhim inteligjence, në funksion të përmbushjes së misionit të saj.

6. “Zonë interesi” është hapësira gjeografike, në të cilën Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes grumbullon informacion për ata faktorë dhe zhvillime që mund të ndikojnë në përmbushjen e misionit të saj.

### Neni 4 **Parimet e veprimtarisë**

Parimet e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes janë ligjshmëria, objektiviteti, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, depolitizimi, bashkëveprimi ndërinstitucional, ruajtja e informacionit të klasifikuar, si dhe kontrolli e mbikëqyrja e veprimtarisë së saj.

## KREU II VEPRIMTARIA DHE ORGANIZIMI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS SË MBROJTJES

### Neni 5 **Organizimi**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes është agjenci e inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë së mbrojtjes, në funksion të misionit kushtetues të Forcave të Armatosura dhe veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes, që vepron në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislationin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes është person juridik publik e buxhetor, që ka stemën dhe flamurin e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes. Kjo agjenci mban numrin kodik dhe atë luftarak, sipas përcaktimeve të autoriteteve ushtarake.

3. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes është në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, me struktura varësie në territoret ku kryejnë veprimtarinë Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit.

4. Struktura, organika dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

5. Procedurat standarde të inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 6

### Misioni i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes ka për mision:

a) mbështetjen e Forcave të Armatosura dhe të autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura me produkt inteligjence dhe kundërinteligjence për sigurinë, në nivel strategjik dhe operacional, në kohë paqeje, lufte, krize, në gjendje të jashtëzakonshme ose në fatkeqësi natyrore;

b) Identifikimin, grumbullimin, analizimin e informacionit për veprimtari që synojnë të cenojnë apo që cenojnë Forcat e Armatosura në kryerjen e misionit të tyre për sigurinë e pavarësisë së vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues të tij, si dhe për kërcënime dhe rreziqe të mundshme ndaj Forcave të Armatosura brenda apo jashtë vendit.

2. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes e realizon misionin e saj edhe nëpërmjet analizës gjithëburimëshe, inteligjencës njerëzore, kundërinteligjencës, sigurisë dhe inteligjencës sinjalore.

#### Neni 7

### Detyrat e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes, në zbatim të misionit të saj, kryen dhe realizon këto detyra:

a) grumbullon, përpunon, analizon, prodhon inteligjencë, administron dhe paraqet informacion për veprimtari, të cilat kërcënojnë e rrezikojnë realizimin e misionit të Forcave të Armatosura për sigurinë e pavarësisë së vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues të tij, planet ushtarake të mbrojtjes, si dhe për veprimtari që lidhen me spiunazhin, ekstremizmin, terrorizmin, sabotazhin, diversionin, subversionin në drejtim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura;

b) paraqet informacione dhe vlerësime për gjendjen e sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura;

c) përmbush detyrimet respektive që rrjedhin nga statusi i vendit anëtar i NATO-s;

ç) mbështet me produkt inteligjence kontingjentet pjesëmarrëse në operacionet që zhvillohen jashtë vendit;

d) merr pjesë në procedurat për pajisjen me certifikatë sigurie të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, të Forcave të Armatosura, strukturave vartëse të tyre, personelit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, si dhe të subjekteve që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie me to;

dh) arsimon dhe trajnon personelin e vet, si dhe të Ministrisë së Mbrojtjes e Forcave të Armatosura, në kuadër të sistemit arsimor të Ministrisë së Mbrojtjes, për çështje të veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;

e) garanton sigurinë e veprimtarisë së vet, të të dhënave të personelit, të kontraktuesve dhe të burimeve materiale që ka në zotërim, përfshirë verifikimin e të dhënave të kandidatëve, të të punësuarve e të kontraktuesve;



- ë) kryen veprimtari mbështetëse tekniko-administrative për interes të vet;
- f) garanton mbrojtjen e sistemeve, në të cilat prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet informacioni i klasifikuar që institucioni ka në zotërim;
- g) krijon qendra të inteligjencës dhe kryen operacione informative në zonat e përgjegjesisë dhe interesit, në përmbushje të misionit të vet.

#### Neni 8

### **Ministri i Mbrojtjes**

1. Ministri i Mbrojtjes, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe bazuar në misionin e Forcave të Armatosura, drejton, nën përgjegjësinë e tij, veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. Ministri i Mbrojtjes përcakton politikat e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në përputhje me politikat shtetërore, duke siguruar bashkëpunimin ndërmjet kësaj agjencie dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura, si dhe me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

3. Ministri i Mbrojtjes, si autoriteti më i lartë përgjegjës për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, ka këto kompetenca:

- a) përcaktimin e përparësive bazuar mbi politikat shtetërore;
- b) informimin e Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit për aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;
- c) nxjerrjen e urdhrave dhe udhëzimeve në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- ç) miratimin e programeve të bashkëpunimit dypalësh e shumëpalësh me shërbimet homologe brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmbushjes së misionit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;
- d) përcaktimin e politikave në fushën e inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;
- dh) miratimin e tabelës së organizimit dhe pajisjeve (TOP) të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;
- e) emërimin, komandimin, lirimin nga detyra, nxjerrjen në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak të punonjësve ushtarakë “oficerë”, si dhe emërimin e lirimin nga detyra të punonjësve civilë, ekuivalentë me “oficer”, në përputhje me tabelat e organizimit e të pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;
- ë) përcaktimin e zonave të përgjegjesisë dhe interesit, si dhe miratimin e krijimit të qendrave të inteligjencës, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 9

### **Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është autoriteti më i lartë drejtues dhe përgjegjës për veprimtarinë e institucionit.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është ushtarak dhe mban gradën Gjeneral Brigade/Kundëradmiral e lart.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes emërohet dhe lirohet nga detyra nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrit.



4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është autoriteti, që përfaqëson strukturat e inteligjencës ushtarake shqiptare në marrëdhëniet me institucionet brenda vendit, NATO-n, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë dhe përcakton përfaqësuesin në mungesë të tij.

#### Neni 10

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) drejtimin, organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në përputhje me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake;

b) realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, kryerjen e kontrollit për plotësimin e tyre dhe sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e agjencisë;

c) komunikimin, informimin dhe bashkëpunimin në mënyrë të drejtpërdrejtë me autoritetet e drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura për çështje që kanë lidhje me kërcënime ndaj pavarësisë së vendit, tërësisë territoriale dhe rendit të tij kushtetues, si dhe ndaj misionit të Forcave të Armatosura;

ç) zbatimin e programeve të Këshillit të Ministrave dhe direktivës së mbrojtjes për çështjet e inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë dhe të kërkesave strategjike për inteligjencë;

d) informimin e Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandantëve të komandave të forcave dhe atyre mbështetëse dhe mbështetjen e tyre me informacionin përkatës në fushën e tyre të përgjegjësisë;

dh) bashkërendimin e punës me strukturat e tjera të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura, veprimtaritë e të cilave ndikojnë në fushën e përgjegjësisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;

e) organizimin e arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit të punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;

ë) garantimin që Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes të jetë politikisht e paanshme;

f) mbrojtjen e burimeve, metodave dhe të dhënave të inteligjencës nga ekspozimi i paautorizuar;

g) planifikimin, programimin dhe menaxhimin e politikave të rekrutimit, karrierës, arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit të personelit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;

gj) organizimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me shërbimet e inteligjencës, vendase dhe të huaja, me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes;

h) dhënien e urdhrave dhe udhëzimeve të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij.

#### Neni 11

#### **Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm**

1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është ndihmësi kryesor i drejtorit të Përgjithshëm të kësaj agjencie. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm emërohet dhe lirohet nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm zëvendëson Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në mungesë të tij, sipas kompetencave të deleguara, si dhe në rastet e pamundësisë së ushtrimit të detyrës, për arsye shëndetësore apo fizike.



3. Zëvendësdirigjenti i Përgjithshëm ushtron edhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara në akte nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji.

#### Neni 12

##### **Marrëdhëniet e bashkëpunimit**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes krijon marrëdhënie bashkëpunimi, në bazë të marrëveshjeve brenda vendit, me:

- a) Shërbimin Informativ të Shtetit;
- b) Ministrinë e Brendshme;
- c) Ministrinë e Punëve të Jashtme;
- ç) Ministrinë e Drejtësisë;
- d) Ministrinë e Financave;
- dh) Prokurorinë e Përgjithshme;
- e) Policinë e Shtetit;
- ë) institucione dhe agjenci të tjera të sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

2. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes krijon marrëdhënie bashkëpunimi jashtë vendit me struktura homologe të inteligjencës dhe sigurisë së vendeve të NATO-s, Bashkimit Europian dhe atyre partnere.

3. Bashkëpunimi me këto institucione dhe shërbime ndërtohet sipas niveleve të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 13

##### **Bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private**

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes bashkëpunon me institucione shtetërore dhe private, duke marrë prej tyre asistencën e nevojshme dhe të dhënat që ato zotërojnë në regjistrat, bazat e të dhënave dhe në dokumentacionin zyrtar, si dhe aksesin në to, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 14

##### **Bashkëpunimi me individë**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes, për plotësimin e misionit, krijon marrëdhënie bashkëpunimi nëpërmjet kontakteve të fshehta me individë, të cilët mbrohen nga ky ligj.

2. Procedurat e këtij bashkëpunimi përcaktohen në rregulloren për procedurat standarde të inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

3. Rekrutimi forcërisht i bashkëpunëtorëve është i ndaluar.

#### Neni 15

##### **Marrja e informacionit nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura**

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes kërkon dhe merr nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Forcave të Armatosura dhe strukturave vartëse të tyre çdo informacion të përfutur zyrtarisht prej tyre, që ka lidhje me misionin e kësaj agjencie.

Neni 16  
**Qendrat e inteligjencës**

1. Në interes të përmbushjes së misionit të saj, Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes krijon qendra inteligjence, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Qendrat e inteligjencës ngrihen jashtë vendit në mënyrë të përkohshme, në zona përgjegjësie dhe interesi, në përmbushje të misionit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në mbështetje të Forcave të Armatosura, pjesëmarrëse në misione dhe operacione ushtarake, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Procedurat e funksionimit të qendrave të inteligjencës përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 17  
**Burimet e informacionit**

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes, për prodhimin e inteligjencës në përmbushje të misionit të saj, përdor këto burime informacioni:

- a) burimet njerëzore;
- b) burimet sinjalore;
- c) burimet e imazheve/fotografive/hartave;
- ç) burimet e hapura;
- d) burimet e informacionit taktik të zbulimit.

Neni 18  
**Procedurat specifike të inteligjencës**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes e ushtron veprimtarinë në përputhje me procedurat specifike të inteligjencës, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe të miratuara me rregullore nga Ministri i Mbrojtjes e Prokurori i Përgjithshëm, të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll për zbatimin e këtyre procedurave.

2. Këto procedura përcaktojnë:

- a) masat e grumbullimit të fshehtë të të dhënave nëpërmjet përgjimit të komunikimeve mobile dhe statike;
- b) mbledhjen e të dhënave nga ndjekja, vëzhgimi dhe përgjimi i personave, mjediseve dhe/ose objekteve, të përcaktuara si objektiv.

3. Ndalohet përdorimi i këtyre procedurave ndaj personave me imunitet, pa marrë më parë miratimin nga organi kompetent.

4. Masat për grumbullimin në fshehtësi të të dhënave zbatohen vetëm në qoftë se të dhënat nuk mund të merren në mënyrë tjetër ose nëse marrja e tyre lidhet me vështirësi të ndryshme.

5. Në rastet kur ekzistojnë mundësi të ndryshme për marrjen në fshehtësi të të dhënave duhet të zgjidhet mundësia që kufizon sa më pak liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

6. Për rastet e kryerjes së operacioneve të fshehta, pjesëtarë të këtyre operacioneve të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes kanë të drejtë të përdorin identitete të rreme. Procedura për marrjen e këtij identiteti rregullohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm. Në të gjitha rastet e aplikimit të kësaj procedure, miratimi bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, duke njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm dhe duke zbatuar të gjitha rregullat për informacionin e klasifikuar.



#### Neni 19

#### **Burimet financiare**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes ka dhe përdor buxhetin e vet, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike nuk zbatohen për veprimtari specifike operative të agjencisë. Përdorimi dhe kontrolli i fondeve për veprimtari specifike operative rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

3. Në funksion të realizimit të detyrave, që rrjedhin nga ky ligj, me qëllim kamuflimi, Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes mund të ketë dhe të administrojë pasuri dhe aktivitete ekonomike. Rregullat dhe procedurat për administrimin e këtyre pasurive dhe aktiviteteve ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 20

#### **Ndalimi i veprimtarisë policore**

Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprimtari të karakterit policor.

#### Neni 21

#### **Ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit**

Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprime për të realizuar qëllime dhe objektiva, që nuk kanë lidhje me misionin e agjencisë.

#### Neni 22

#### **Informacionet**

Informacionet e grumbulluara nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes nuk përbëjnë bazë ligjore për kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë.

#### Neni 23

#### **Përgjashtimi nga publikimi**

Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes përgjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të numrit të punonjësve të kësaj agjencie.

#### Neni 24

#### **Kontrolli dhe raportimet për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Autoritetet, që kanë të drejtën e ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, janë:

- a) Kuvendi;
- b) Kryeministri;
- c) Ministri i Mbrojtjes.

2. Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, i autorizuar prej tij, raporton për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në komisionin apo nënkomisionin përgjegjës parlamentar, lidhur me çështjet e inteligjencës dhe sigurisë, të paktën një herë në vit, si dhe sa herë që kërkohet prej tyre.

3. Kontrolli i ushtruar dhe raportimet e bëra nga autoritetet e sipërpërmendura kryhen duke ruajtur burimet dhe informacionet e klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 25 **Arkivi**

1. Për përpunimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë, Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes ka arkivin e vet, i cili krijohet dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

2. Procesi i klasifikimit dhe deklasifikimit të dokumenteve kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

### KREU III STATUSI, KLASIFIKIMI, PRANIMI DHE VLERËSIMI I PUNONJËSVE TË AGJENCISË SË INTELIJENCËS SË MBROJTJES

#### Neni 26 **Marrja dhe humbja e statusit**

1. Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes gëzojnë status të veçantë, sipas këtij ligji. Këtë status e gëzojnë:

a) punonjësit ushtarakë dhe civilë në detyrë;

b) punonjësit në rezervë, në lirim ose në pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes e humbasin këtë status në rastin kur dënohen me vendim të formës së prerë nga gjykata, me burgim për krime të kryera me dashje, si dhe kur punonjësit ndërpresin marrëdhëniet e punës me këtë agjenci, pa shkaqe ligjore.

3. Punonjësit ushtarakë të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, përveç përcaktimeve të parashikuara në këtë ligj, kanë dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga statusi për ushtarakun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 27 **Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, ushtarakë ose civilë, që shërbejnë në strukturat e kësaj agjencie, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

2. Punonjësit civilë të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përbëjnë deri në 40 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve të kësaj agjencie.

3. Detyrat funksionale të punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përcaktohen me rregullore të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj agjencie.

#### Neni 28 **Klasifikimi i funksioneve**

Funksionet në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes klasifikohen si më poshtë:

a) funksion i nivelit të lartë drejtues;



- b) funksion i nivelit të mesëm drejtues;
- c) funksion i nivelit zbatues;
- ç) funksion i nivelit mbështetës.

#### Neni 29

### **Kriteret për emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes emërohet ushtaraku që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji, ka edhe nivelin e kualifikimit më të lartë në fushën e inteligjencës dhe të mbrojtjes.

#### Neni 30

### **Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes emërohet për një periudhë kohe prej 4 vjetësh, me të drejtë riemërimi.

#### Neni 31

### **Kriteret për emërimin e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm**

Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji, përmbush edhe këto kritere:

- a) Të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se dhjetë vjet në strukturat e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, strukturat e shërbimeve informative ose me natyrë të ngjashme me to apo në strukturat e Forcave të Armatosura;
- b) Të ketë arsimimin më të lartë në fushën e inteligjencës dhe të mbrojtjes.

#### Neni 32

### **Lirimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes lirohet nga detyra për njërin nga arsyet e mëposhtme:

- a) është dënuar për një vepër penale me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) plotëson moshën për pension të plotë pleqërie;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj për paaftësi ose pamundësi fizike dhe shëndetësore;
- d) i mbaron mandati;
- dh) për shkelje të rënda disiplinore;
- e) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;
- ë) për shkelje të dispozitave të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të legjislacionit gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Neni 33

**Emërimi dhe lirimi i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, oficer dhe civil, ekuivalent, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar dhe civil, ekuivalent me ta, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 34

**Kriteret e pranimit**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për t'u pranuar në agjenci, duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë gradën ose nivelin arsimor për vendin përkatës të punës;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- d) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
- dh) të plotësojë kushtin për pajisje me certifikatë sigurie;
- e) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- ë) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;

f) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

g) të mos ketë konflikt interesi me detyrën/funksionin që do të kryejë.

2. Për pranimin në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes në funksione të veçanta, përveç kriterëve të përgjithshme të përmendura në pikën 1 të këtij neni, shtetasi duhet të plotësojë edhe disa kriteret të veçanta, të përcaktuara në rregulloren e personelit, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 35

**Pranimi i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Përzgjedhja e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në këtë agjenci bëhet me konkurrim të hapur.

2. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në dy gazeta me qarkullim të madh kombëtar, të paktën 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim. Shpallja përmban kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati, dhe përcakton fushën në të cilën do të zhvillohet konkurrimi.

3. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përzgjidhet nga Komisioni i Testimit në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes, pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak të dokumentacionit, testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

4. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përzgjidhet nga komisioni i testimit në bazë të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes propozon për emërim nga kontingjenti i përzgjedhur, kandidatin që plotëson më së miri kushtet.



5. Pranimi në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes mund të kryhet pa konkurrim, në raste të veçanta, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Rastet e veçanta, kriteret dhe procedura e pranimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

#### Neni 36

##### **Komisioni i testimit**

1. Komisioni i testimit ngrihet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe zhvillon testimin e kandidatëve për t'u pranuar në këtë agjenci.

2. Procedurat e zhvillimit të testimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 37

##### **Periudha e provës**

1. Punonjësi civil, që pranohet në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes, i nënshtrohet një periudhe prove prej 6 muajsh, e cila fillon nga data e emërimit. Gjatë kësaj periudhe ai është nën kujdesin e eprorit të tij dhe vlerësohet nga ky i fundit. Për periudhën e provës punonjësi lidh kontratë individuale.

2. Në fund të periudhës së provës, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i propozon Ministrit të Mbrojtjes, për punonjësin civil, në kompetencë të tij, emërimin në detyrë si punonjës i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ose lirimimin nga detyra.

Me punonjësin, që do të pranohet në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes, lidhet kontratë individuale e punës.

3. Punonjësi gëzon të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes për periudhën e provës.

#### Neni 38

##### **Vlerësimi i punës**

1. Vlerësimi i punës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes bëhet një herë në vit.

2. Procedurat e vlerësimit për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

3. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes vlerësohet sipas formularit të vlerësimit që aplikohet për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

4. Shkallët e vlerësimit për punonjësin civil janë:

- a) shumë mirë;
- b) mirë;
- c) mjaftueshëm;
- ç) jomjaftueshëm.

#### Neni 39

##### **Ngritja në detyrë**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes mund të ngrihet në detyrë kur vlerësohet “shumë mirë” ose “mirë” dhe kur ekziston vend pune i lirë.



2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, që ka masë disiplinore të pashlyer, nuk mund të ngrihet në detyrë.

#### Neni 40 **Komandimi**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, oficer dhe civil, ekuivalent sipas tabelës së organizimit e pajisjeve, për nevoja pune, komandohet në detyrë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar dhe civil, ekuivalent me ta, sipas tabelës së organizimit e pajisjeve, për nevoja pune, komandohet në detyrë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

3. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur para komandimit.

4. Punonjësit të komanduar jashtë vendbanimit të tij i sigurohet ushqimi, transporti dhe fjetja nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes. Masa dhe mënyra e këtij trajtimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

#### Neni 41 **E drejta e gradës dhe e karrierës**

1. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes oficer, nënoficer dhe ushtar, e fiton gradën sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon gradat dhe karrierën për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, oficer, konkurren për gradat nënkolonel/kapiten i rangut II dhe kolonel/kapiten i rangut I, kur ka kryer kursin e avancuar të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes ose kurset e njësuara në Akademinë e Mbrojtjes.

### KREU IV DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS SË MBROJTJES

#### Neni 42 **Përgjegjshmëria në ushtrimin e detyrës**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, duhet:

a) të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

b) të ushtrojë me përkushtim detyrën dhe të veprojë me profesionalizëm e me përgjegjësi;

c) të jetë i paanshëm, objektiv, i drejtë dhe të mos niset nga interesi i përfitimit personal e të mos krijojë favore për individë të caktuar, duke u kushtëzuar nga motive, që nuk lidhen me realizimin me ndërgjegje të detyrës;

ç) të realizojë me besnikëri detyrat e funksionet zyrtare, pavarësisht nga pikëpamja personale, dhe të zbatojë me përpikëri urdhrat ose vendimet e organeve eprorë;

d) të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet dhe mosveprimet e veta gjatë ushtrimit të detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave e të vendimeve, të vërë në dijeni menjëherë urdhërdhënësin dhe eprorët e këtij të fundit;



- dh) të zbatojë rregullat e etikës;
  - e) të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese.
2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është i detyruar të kryejë të gjitha detyrat, për të cilat është i ngarkuar.

#### Neni 43

#### **Ruajtja e dinjitetit**

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë dinjitetin dhe integritetin e institucionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe sa herë që paraqitet në publik, si dhe të mbajë komunikime zyrtare me palët e treta.

#### Neni 44

#### **Depolitizimi**

1. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i ndalohen anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive apo të shoqatave politike, si dhe të kryejë veprimtari në favor ose kundër partive, shoqatave politike apo kandidatëve në zgjedhje.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes nuk duhet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit.

#### Neni 45

#### **Kufizimi i së drejtës së grevës**

Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes nuk i lejohet të bëjë grevë, si dhe të bëjë ankesa kolektive.

#### Neni 46

#### **Dypunësimi**

1. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i ndalohet të punësohet pranë personave fizikë e juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, si dhe të kryejë veprimtari të tjera fitimprurëse ose jo, brenda orarit zyrtar të punës.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ka të drejtë të ushtrojë veprimtari të tjera të ligjshme jashtë detyrës dhe kohës së punës, në qoftë se një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesi me detyrën e tij zyrtare dhe nuk e pengon apo ndikon atë në ushtrimin e saj.

3. Në çdo rast, ushtrimi i kësaj të drejte bëhet me miratimin paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 47

#### **Ruajtja e informacionit të klasifikuar**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë informacionin e klasifikuar dhe sekretin profesional.

2. Për shkelje të pikës 1 të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, ndaj personave përgjegjës merren masa disiplinore, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit, sipas pikës 1 të këtij neni, zgjat edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 48  
**Ruajtja e aktiveve**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë e të mirëmbajë mjediset e punës dhe mjetet e dhëna në përdorim për kryerjen e detyrës.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përgjigjet për dëmin që u shkakton, me dashje apo nga pakujdesia, aktiveve të agjencisë. Në këtë rast, brenda 6 muajve nga data e zbulimit të dëmit, por jo më vonë se 3 vjet nga data e shkakimit të dëmit, nxirret urdhri i zhdëmtimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur punonjësi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me agjencinë.

3. Kundër urdhrin të zhdëmtimit, punonjësi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 49  
**Dëmi i shkaktuar ndaj të tretëve**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i kësaj agjencie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ndaj shtetasve ose personave fizikë e juridikë.

2. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi përgjegjës për dëmin e shkaktuar shpenzimet e zhdëmtimit.

3. Për përgjegjësinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, përgjegjësinë vetjake të punonjësve të saj, rastet e shkakimit të dëmit ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, si dhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.

Neni 50  
**Kufizimi i lirisë së lëvizjes**

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ka të drejtë të dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me leje me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 51  
**E drejta e pagesës**

1. Paga mujore e punonjësit ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është sipas strukturës së pagës të ushtarakut të Forcave të Armatosura.

Paga mujore e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është sipas legjislacionit në fuqi që përcakton pagat e punonjësve të administratës shtetërore.

2. Për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ka përparësi në trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë.

3. Pagat dhe shtesat mbi pagë për punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52  
**Sigurimet shoqërore suplementare**

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, përveç përfitimeve të përcaktuara në këtë ligj, ka të drejtën e përfitimeve shoqërore suplementare.



2. Për efekt të përfitimit të sigurimeve shoqërore suplementare, si vjetërsi shërbimi do të njihet periudha nga momenti i emërimit deri në momentin e lirimit nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 53

##### **Kohëzgjatja e punës**

1. Kohëzgjatja normale e punës për punonjësin e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes njihësohet me atë të punonjësve të administratës publike.

2. Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, koha e punës mund të zgjatet tej kohës normale me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ose të eprorit të punonjësit. Në këto raste, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 54

##### **Kohëzgjatja e pushimit**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes gëzon të drejtën e pushimit javor, të pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjësin ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes është sipas legjislacionit në fuqi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, ndërsa për punonjësin civil të kësaj agjencie është sipas legjislacionit në fuqi për administratën publike.

3. Kur pushimi vjetor për punonjësin e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për arsye pune ose shërbimi, nuk jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt, paguhet për lejen e pakryer.

4. Kur punonjësi, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paaftë për punë dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, ai njofton Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

5. Në rast të martesës së tij ose të pjesëtarëve të familjes apo në rast fatkeqësie familjare ose sëmundjeje të rëndë të pjesëtarëve të familjes dhe në raste të tjera të ngjashme me to, punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, i jepen deri në 5 ditë leje të pagueshme ose deri në 45 ditë leje, pa të drejtë page.

#### Neni 55

##### **Dokumenti i identifikimit dhe armatimi**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes pajiset me dokument zyrtar identifikimi.

2. Forma e dokumentit të identifikimit miratohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, sipas funksioneve të veçanta, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, pajiset me armatim personal, të cilin e mban dhe e përdor në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, kur ndërpret marrëdhëniet e punës, dorëzon dokumentin e identifikimit dhe armatimin.

5. Kur punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes vdes, familjarët e tij dorëzojnë dokumentin e identifikimit dhe armatimin e tij, brenda 30 ditëve në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes.

Neni 56  
**Uniforma**

Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në varësi të natyrës së detyrës ose operacioneve, mban uniformë ushtarake ose veshje civile.

Neni 57  
**Trajtimi me ushqim e veshmbathje**

Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes trajtohet me ushqim dhe veshmbathje, sipas kriterëve, normave, mënyrave dhe masës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 58  
**Mbrojtja e veçantë**

1. Kur punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ose personit që krijon marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci, për shkak të detyrës ose bashkëpunimit, i kërcënohet jeta, shëndeti, familja a prona, i garantohet mbrojtje e veçantë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes dhe me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. Mënyrat dhe kriteret e mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 59  
**Edukimi dhe trajnimi**

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes gëzon të drejtën e arsimimit, trajnimit profesional, kurseve, seminareve dhe studimeve, brenda dhe jashtë vendit, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për kurset dhe/ose seminarët e zhvilluara në Qendrën e Trajnimit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, pajiset me certifikatën përkatëse.

Neni 60  
**Qendra e Trajnimit të Inteligjencës**

1. Qendra e Trajnimit të Inteligjencës (QTI) është pjesë e strukturës së Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, e cila organizon trajnimin për përgatitjen profesionale të punonjësve në tri nivele, fillestar, bazë dhe të avancuar, duke mbuluar disiplina të inteligjencës, kundërinteligjencës dhe sigurisë.

2. Modelet e certifikatave miratohen nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.



## KREU V MBROJTJA SHOQËRORE E PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS SË MBROJTJES

### Neni 61

#### **Pagesa e papunësisë për bashkëshortin/bashkëshorten i/e papunë**

1. Kur bashkëshortja/bashkëshorti humbet vendin e punës, për shkak të emërimit të punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes jashtë vendbanimit të përhershëm, këtij të fundit i jepet pagë papunësie në emër të bashkëshortes/bashkëshortit, deri në 5 vjet, në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/bashkëshortit të punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për një periudhë deri në 5 vjet, njihet si vjetërsi sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie. Kontributi për këtë periudhë përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, akorduar për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes. Kriteret dhe masa e kontributit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkëshortja/bashkëshorti e/i punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes e përfiton pagën e papunësisë edhe për periudhën kur punonjësi lirohet nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes ose vdes, por jo më shumë se periudha e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Përfashtohen nga përfitimi i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, bashkëshortja/bashkëshorti e/i punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, të cilët lirohen nga detyra për shkelje disiplinore ose dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

### Neni 62

#### **E drejta për përfitim kredie me interesa të butë**

1. Ministria e Mbrojtjes lidh marrëveshje me institucionet kredidhënëse, me qëllim trajtimin me kredi për strehim të punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, të pastrehuar me banesë apo me sipërfaqe të vogël banimi, brenda mundësive dhe limiteve buxhetore që ajo disponon.

2. Ministria e Mbrojtjes përballon pjesërisht interesat e kredisë për çdo përfitues të trajtuar sipas këtij neni dhe i planifikon këto shpenzime në buxhetin e saj të çdo viti, që i akordon Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Përfituesi përballon interesat e kredisë në masën 5 për qind dhe principalin.

3. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, i cili është trajtuar sipas këtij neni, në rastin kur ndërpret marrëdhëniet e punës dhe nuk ka shlyer detyrimet përkatëse, vazhdon t'i shlyejë ato si punonjësi në detyrë, në masën e përcaktuar.

4. Ministria e Mbrojtjes nuk trajton me kredi punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, që kanë dalë në rezervë, lirim, si dhe që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkelje disiplinore ose kur dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Kriteret për përfitim të kredisë dhe masa e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 63

#### **Kompensimi për strehim**

1. Punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, kur emërohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, i jepet kompensim për qira banese, kur nuk i sigurohet banesë nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Kriteret dhe masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 64

**Trajtimi i familjarëve të personit që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj**

Familja e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, i cili humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, si dhe familja e personit, i cili ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes dhe humbet jetën për shkak të këtij bashkëpunimi, përfiton kompensim të veçantë, masa e të cilit përcaktohet, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 65

**Mbështetja arsimore**

Fëmijët e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, kur fitojnë të drejtën e ndjekjes së arsimit të lartë, përfitojnë nga shteti bursë të plotë, brenda planit të bursave, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për vitin akademik përkatës.

Neni 66

**Ndihma financiare në raste vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie**

1. Kur punonjësi civil në detyrë i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes vdes, sëmuret rëndë e për një kohë të gjatë, të vërtetuar me raport mjekësor, ose pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 6 paga mujore.

2. Punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 3 paga mujore, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij është i sëmurë rëndë dhe për një kohë të gjatë ose vdes.

3. Kur punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në detyrë vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet, sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

**KREU VI**

**NDËRPRERJA E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS DHE DISIPLINA**

Neni 67

**Lirimi nga detyra i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes lirohet nga detyra dhe ndërpret marrëdhëniet e punës në rastet kur:

- a) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;
- b) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë 6 muaj për pamundësi fizike dhe shëndetësore;
- c) bëhet i paaftë përgjithmonë për të kryer detyrat e tij, për shkak të kushteve shëndetësore;
- ç) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;



d) jep dorëheqjen, e cila miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes;

dh) ka ristrukturim dhe/apo shkurtim funksioni organik;

e) dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ë) i hiqet e drejta e ushtrimit të detyrës me vendim gjyqësor të formës së prerë;

f) për shkelje të rënda disiplinore;

g) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe të institucionit;

gj) i mbaron kontrata e punës;

h) kryen veprimtari që krijojnë konflikt interesash;

i) konkludohet paaftësia për të kryer detyrat, të paktën pas dy vlerësimeve negative të njëpasnjëshme të rezultateve në punë.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes nxirret në rezervë/lirim, sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon gradat dhe karrierën për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

#### Neni 68

##### **Disiplina**

1. Punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes u jepen masa disiplinore për mosplotësimin e detyrave, për thyerje të disiplinës në punë e të rregullave të etikës, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore dhe për raste të tjera, të parashikuara nga ky ligj.

2. Masat disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, miraton rregulloren e disiplinës për punonjësit civilë, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për zbatim.

3. Masat disiplinore jepen për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, kur veprimet dhe mosveprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale.

4. Për punonjësin ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes zbatohet legjislacioni në fuqi për disiplinën për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

#### Neni 69

##### **Llojet e masave disiplinore**

Llojet e masave disiplinore për punonjësit civilë janë:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët, për një periudhë deri në 1 vit;

ç) lirim nga detyra.

#### Neni 70

##### **Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj për punonjësin civil**

1. Procedimi disiplinor fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se një vit nga çasti i kryerjes së saj.

2. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerr eprori direkt i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes. Eprori i punonjësit, për të cilin konstatohet një shkelje disiplinore, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes një rën nga masat disiplinore sipas nenit 69 të këtij ligji. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, pas propozimit për dhënien e masës disiplinore, vendos për dhënien, mosdhënien ose ndryshimin e saj.



3. Masat disiplinore, sipas shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 69 të këtij ligji, jepen nga autoritetet sipas përkatësisë së emërimit të punonjësve. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes jep masat e tjera disiplinore.

4. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose sipas rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

5. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet me shkrim të interesuarit.

6. Masat e përcaktuara në nenin 69 të këtij ligji, me përjashtim të masës së përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 69 të këtij ligji, shlyhen, nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre, ndaj personit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

#### Neni 71

### **Njohja me dokumentacionin e procedimit**

1. Punonjësit civil të proceduar i jepet dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij menjëherë, para shqyrtimit të shkeljes, nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, për të pasur mundësi për të përgatitur mbrojtjen.

2. Punonjësi civil i proceduar njoftohet për datën kur do të shqyrtohen materialet, që lidhen me të, jo më vonë se 5 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit për përgatitjen e mbrojtjes.

#### Neni 72

### **E drejta për t’u dëgjuar**

1. Punonjësi civil, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë para Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.

2. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në seancën dëgjimore nuk e pengon Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

#### Neni 73

### **Marrja e masës disiplinore**

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes shprehet brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së pretendimeve nga punonjësi civil i proceduar disiplinarisht.

#### Neni 74

### **Ankimi**

1. Kundër vendimit për dhënien e masave disiplinore, punonjësit civil, të cilit i është dhënë masa, i lind e drejta ta ankimojë atë brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të saj te Ministri i Mbrojtjes ose te Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, sipas përkatësisë së dhënies së masës.

2. Për shqyrtimin e ankesës për masat disiplinore, Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes ngre një komision disiplinor, i cili brenda 10 ditëve propozon për lënien në fuqi, ndryshimin ose heqjen e masës disiplinore të marrë. Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, pas shqyrtimit të propozimit të komisionit, merr vendimin përfundimtar.



3. Kundër dhënies së masës disiplinore, të parashikuar në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 69 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

4. Përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

#### Neni 75

### **Pezullimi dhe ruajtja e vendit të punës së punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes**

1. Kur ndaj punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes fillon ndjekja penale, ai mund të pezullohet me urdhër të autoritetit që e ka emëruar, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata. Kur punonjësi deklarohet i pafajshëm ose kur çështja penale ndaj tij pushohet, ai rikthehet në vendin e punës dhe përfiton pagën bazë që nga çasti i pezullimit të tij.

2. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes pezullohet edhe për periudha studimi më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vet, por në lidhje me profesionin që ai ushtron dhe të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes. Për këtë rast, punonjësi nuk paguhet dhe vendi i punës i ruhet, por jo më shumë se 1 vit.

3. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes pezullohet edhe kur emërohet në funksione diplomatike, civile ose politike. Në këtë rast, vendi i punës i ruhet, por jo më shumë se 4 vjet.

## KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 76

### **Dispozita kalimtare**

1. Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes trashëgon të gjitha detyrimet, të drejtat, arkivin dhe aktivet e Shërbimit Informativ Ushtarak (SHIU).

2. Për zbatimin e nenit 52 të këtij ligji, Ministria e Financave, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqet për miratim përfshirjen e punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Deri në daljen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen aktet nënligjore në fuqi për Shërbimin Informativ Ushtarak, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

#### Neni 77

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore:

a) Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikës 2 të nenit 5, të pikave 2 e 3 të nenit 19, të pikës 4 të nenit 40, të pikës 3 të nenit 51, të nenit 57, të pikës 2 të nenit 58, të pikave 1 e 2 të nenit 61, të pikës 5 të nenit 62, të pikës 2 të nenit 63 dhe të pikës 3 të nenit 66 të këtij ligji;

b) Kryeministri, në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji;

c) Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të pikës 5 të nenit 5, të pikës 3 të nenit 16, të pikave 1 e 6 të nenit 18, të pikës 2 të nenit 34, të pikës 5 të nenit 35, të pikës 2 të nenit 36, të pikës 2 të nenit 38, të pikës 2 të nenit 55, të pikës 2 të nenit 60, të pikës 2 të nenit 68 dhe të pikës 4 të nenit 74 të këtij ligji;

ç) Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, në zbatim të pikës 3 të nenit 27 të këtij ligji.

#### Neni 78 Shfuqizime

Ligji nr. 9074, datë 29.5.2003 “Për Shërbimin Informativ Ushtarak” dhe ligji nr. 9295, datë 21.10.2004 “Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak” shfuqizohen.

#### Neni 79 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7875, datë 26.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

### LIGJ Nr. 118/2012

#### **PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

<sup>1</sup>Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën nr. 2008/68/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të 24 shtatorit 2008 “Mbi transportin e mallrave të rrezikshme”, numri CELEX 32008L0068, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 260, datë 30.9.2008, faqe 13-59, i cili shfuqizon direktivën 94/55/EC, 96/49/EC, 96/35/EC dhe 2000/18/EC.

Plotësisht me direktivën e Këshillit nr. 95/50/EC të 6 tetorit 1995 “Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë”, numri CELEX 31995L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 249, datë 17.10.1995, faqe 35-40.

Pjesërisht me direktivën 2010/35/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të 19 qershorit 2010 mbi pajisjet e transportueshme nën presion dhe shfuqizon direktivat 76/767/EEC, 84/525/EEC, 84/526/EEC dhe 1999/36/EC, nr. CELEX 32010L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, nr.165, 30.6.2010, faqe 1-18.



## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim rritjen e sigurisë në transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

### Neni 2 **Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e:

- a) procedurave, sipas të cilave duhet të kryhet transporti rrugor e hekurudhor i mallrave të rrezikshme, në vazhdim transporti i mallrave të rrezikshme;
- b) detyrimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë lloj transporti, si dërguesi, transportuesi, marrësi i ngarkesës, ambalazhuesi, përgatitësi i paketave për transport, ngarkuesi, mbushësi e shkarkuesi;
- c) kushteve të trajnimit dhe testimit të personave që mbulojnë ambalazhimin, përgatitjen e paketave për transport, dërgimin, transportin, ngarkimin, mbushjen, shkarkimin dhe marrjen e mallrave të rrezikshme;
- ç) procedurave për caktimin e këshilltarëve të sigurisë, trajnimin e provimin e tyre;
- d) kushteve që duhet të plotësojnë mjetet e transportit të përfshira në këtë lloj transporti dhe drejtuesit e këtyre mjeteve;
- dh) kompetencave të organeve shtetërore, në lidhje me transportin dhe mbikëqyrjen në zbatimin e këtij ligji.

### Neni 3 **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose nga territori i një pale tjetër kontraktuese për në territorin e Republikës së Shqipërisë apo nga territori i Republikës së Shqipërisë për në territorin e një pale tjetër kontraktuese.

2. Ky ligj nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme:

- a) me mjete që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjen/marrëveshjet në fuqi;
- b) brenda perimetrit të një zone të mbyllur, ku mallrat mund të prodhohen, të trajtohen, të përpunohen, të ruhen, të sistemohen apo të transferohen në hapësirën e brendshme;
- c) kur ky proces është në përputhje me dispozitat përjashtuese të ADR-së ose RID-it.

### Neni 4 **Përkufizime**

A. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administruesi i infrastrukturës hekurudhore” është personi juridik, publik ose privat, pronar ose jo i një infrastrukture hekurudhore, që e administron dhe e mirëmban atë për ta shfrytëzuar vetë ose nëpërmjet të tretëve.

2. “ADR” janë anekset A dhe B të marrëveshjes europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, të rishikuar ose të ribotuar, herë pas here, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.

3. “Agjencia Kombëtare Bërthamore” është organi, funksionet dhe kompetencat e të cilit janë parashikuar në legjislacionin në fuqi.

4. “Aksident” është ngjarja që, si rezultat i ose gjatë së cilës, në rastin e transportit të mallrave të rrezikshme, përfundon me dëmtime në njerëz dhe/ose me dëmtime të mjedisit.

5. “Ambalazhues” është subjekti, i cili vendos mallrat e rrezikshme brenda në ambalazh, duke përfshirë ambalazhimin e madh dhe konteinerët e ndërmjetëm për mallrat ose artikujt e ngurtë dhe, kur është e nevojshme, parapërgatit paketat për transportim.

6. “Autoriteti Rrugor Shqiptar” është personi juridik, publik, funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilit janë parashikuar në dispozitat e ligjit nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

7. “Certifikatë e miratimit të mjetit, sipas ADR-së” është certifikata e miratimit të mjetit, e lëshuar nga institucionet, sipas nenit 37 të këtij ligji, që vërteton se një mjet i vetëm i destinuar për transportin e disa mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse, sipas marrëveshjes së përmendur në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

8. “Certifikatë trajnimi” është certifikata e lëshuar për personin, i cili ka kaluar një provim të miratuar nga autoriteti përgjegjës në transportin e mallrave të rrezikshme.

9. “Dërgues i mallrave” është subjekti, i cili dërgon mallra të rrezikshme ose në emrin e tij, ose në emër të një palë të tretë. Nëse operacioni i transportit kryhet sipas një kontrate për transportin, dërguesi nënkupton dërguesin, në përputhje me kontratën për transportin.

10. “Dërgesë (ngarkesë)” është paketa ose paketat apo ngarkesa e mallrave të rrezikshme, të paraqitura nga dërguesi për transport.

11. “Ekuipazh i mjetit” janë personat e autorizuar nga ndërmarrja e transportit për të qëndruar në bordin e mjetit.

12. “Incident” është çdo ngjarje, e ndryshme nga një aksident ose një aksident i rëndë, e lidhur me operimin e mjeteve të transportit dhe që prek sigurinë e shfrytëzimit.

13. “Inspektorët e kontrollit” janë personat e autorizuar për kontrollin në rrugë, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe inspektorët e kontrollit hekurudhor, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

14. “Kontroll” është çdo kontroll, inspektim, verifikim ose formalitet, kryer nga organet përgjegjëse për arsye të sigurisë që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme në zbatim të këtij ligji dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

15. “Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi” është organi i ngritur me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”.

16. “Këshilltar i sigurisë” është personi i caktuar ose i emëruar nga një subjekt, roli i të cilit është kryerja e detyrimeve dhe përbushja e funksioneve të përmendura në nenin 29 të këtij ligji, dhe i cili zotëron certifikatën e trajnimit, sipas nenit 28 të këtij ligji.

17. “Mallra të rrezikshme” janë ato substanca ose artikuj, transporti me rrugë ose me hekurudhë i të cilëve është i ndaluar ose i autorizuar vetëm në rrethana të caktuara nga ADR-ja ose RID-i.

18. “Marrës i mallrave” është marrësi, në përputhje me kontratën për transportin. Nëse marrësi cakton një palë të tretë, në përputhje me dispozitat e aplikueshme në kontratën për transportin, ky person gjykohet si marrës brenda kuptimit të marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji. Nëse operacioni i transportit kryhet pa një kontratë për transportin, subjekti, i cili merr përgjegjësinë për mallrat e rrezikshme, në mbërritje gjykohet si marrësi i mallrave.



19. “Mbushës” është subjekti, i cili ngarkon mallra të rrezikshme në cisternë (mjet-cisternë ose vagon-cisternë, cisternë të çmontueshme, cisternë të transferueshme ose konteiner-cisternë) dhe/ose brenda në mjet, në konteiner të madh ose të vogël për transportin e mallrave në formë të kokrrizuar ose të grimtuar etj.

20. “Ministria” është ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit.

21. “Ministria përgjegjëse” është ministria përgjegjëse për fushën përkatëse.

22. “Ministri” është ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit.

23. “Ministri ose organi përgjegjës” është ministri ose organi përgjegjës për fushën përkatëse.

24. “Mjedis” janë zyrat, ndërtesa e rezidencës, konstruksioni i përkohshëm ose mjete.

25. “Mjet” është çdo mjet i përcaktuar në marrëveshjen e përmendur në nenin 5 të këtij ligji.

26. “Ngarkues” është subjekti, i cili ngarkon mallrat e rrezikshme në mjet ose në konteiner.

27. “Numri UN” është numri identifikues katërshifror i substancës ose artikullit të marrë nga rregulloret model të Kombeve të Bashkuara.

28. “Operatori i konteinerit-cisternë ose cisternës së transferueshme apo i vagonit-cisternë” është subjekti, në emrin e të cilit është i regjistruar konteineri-cisternë ose cisterna e transferueshme apo vagoni-cisternë.

29. “Organi përkatës administrativ” është organi, i cili është i ngarkuar me aktin ligjor apo nënligjor përkatës, për menaxhimin e trafikut të mallrave të rrezikshme.

30. “Paketë” është produkti i përfunduar i procesit të ambalazhimit, i përgatitur për dërgim, i përbërë nga ambalazhi, ose ambalazhi i madh apo konteiner i ndërmjetëm për substanca solide dhe përmbajtja e tij. Me këtë term nënkuptohen edhe bombolat e gazit, siç janë të përkufizuara, si dhe artikuj që për nga madhësia, pesha apo konfigurimi, mund të transportohen të paambalazuara në mbajtëse, arka ose pajisje trajtimi. Me përjashtim të transportit të materialeve radioaktive, termi nuk zbatohet as për mallrat e ngurta të transportuara në sasi të mëdha e as për substancat e transportuara me cisternë.

31. “Pajisje e transportueshme nën presion” është çdo rezervuar dhe cisternë, duke përfshirë mjetet-cisternë, cisternat e çmontueshme, konteinerët-cisternë, vagonët-cisternë, bombolat, tubat dhe çdo lidhje tjetër që përdoren për transportin e gazeve ose substancave të tjera të rrezikshme.

32. “Palë kontraktuese” është shteti që është palë në marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji.

33. “Pjesëmarrës” është personi ose subjekti i përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe i lidhur me veprimtaritë e ngarkimit, të shkarkimit, të paketimit e të mbushjes dhe përfshin dërguesin, transportuesin, marrësin, ngarkuesin, mbushësin, paketuesin, shkarkuesin, operatorin e cisternës së transferueshme ose konteinerit-cisternë, të vagonit -cisternë, drejtuesin e mjetit, këshilltarin e sigurisë dhe organin inspektues.

34. “Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile” është struktura e përhershme, në kohë normale, dhe struktura e përkohshme, në raste emergjencash civile, funksionet dhe kompetencat e së cilës janë parashikuar me ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”.

35. “RID” është aneksi i rregullores, në lidhje me transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, i cili përbën aneksin C të COTIF-it, i rishikuar ose i ribotuar, herë pas here, sipas pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji.

36. “Shkarkues” është subjekti, i cili shkarkon mallrat e rrezikshme nga mjete, konteineri ose cisterna.

37. “Transport” është operacioni i transportit, i kryer me anë të një mjete, plotësisht ose pjesërisht në rrugët publike, ose operacioni i transportit me hekurudhë, i drejtuar plotësisht ose pjesërisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, gjatë të cilave përfshihen veprimtaritë e

ngarkimit, të shkarkimit, të ambalazhimit e të mbushjes, por nuk përfshihet transporti i kryer plotësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur, e cila nuk është e hapur për publikun.

38. “Transportues” është subjekti, i cili kryen operacione transporti me ose pa kontratë transporti.

39. “Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)” është njësi ekzekutive e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.

B. Termat ose shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptim të njëjtë me ato që përdoren në marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji.

#### Neni 5

### Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme zbatohet ligji nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”, Gjenevë, më 30 shtator 1957, me pjesët e saj përbërëse, anekset A dhe B.

2. Për transportin ndërkombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme zbatohet dekreti nr. 6845, datë 6.12.1983 “Për aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për transportin e mallrave me hekurudhë (CIM)” dhe në konventën “Për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF)”, aneksi C, “Rregullat në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë (RID)””.

3. Për transportin e substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore zbatohet ligji nr. 8853, datë 31.1.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”” dhe ligji nr. 10 379, datë 24.2.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive””.

#### Neni 6

### Transporti me shtete jo palë kontraktuese

Transporti i mallrave të rrezikshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një shteti, i cili nuk është palë kontraktuese në marrëveshjet e parashikuara në nenin 5 të këtij ligji, lejohet për aq sa ky transport përputhet me dispozitat e këtij ligji.

#### KREU II

### PROCEDURA TË PËRGJITHSHME

#### Seksioni I Ambalazhet

#### Neni 7

### Ambalazhet e lejuara

Për transportin e mallrave të rrezikshme lejohen vetëm ambalazhet:

a) të cilat sipas cilësisë dhe formës së ndërtimit përshtaten me sasinë dhe specifikat e mallrave të rrezikshme që transportohen në këto ambalazhe;

b) të cilat janë në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it për lejimin e transportit të mallrave të rrezikshme;

c) të cilat janë të testuara dhe të miratuara në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;



ç) të cilat kanë shenjat paralajmëruese, mbishkrimet, shenjat dhe etiketat që tregojnë rrezikun dhe të dhëna të tjera për mallrat e rrezikshme dhe ambalazhin, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

#### Neni 8

##### **Miratimi i ambalazhit**

1. Prodhuesi i ambalazhit për mallrat e rrezikshme merr miratimin për prodhimin e ambalazhit nga institucionet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.

2. Prodhuesi i ambalazhit është i detyruar të vendosë shenjat e miratimit, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

3. Prodhuesi i ambalazhit për mallrat e rrezikshme nuk vendos shenja për të treguar miratimin, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse ambalazhi nuk është në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

#### Neni 9

##### **Pajisjet e transportueshme nën presion dhe ambalazhet e tjera**

1. Miratimi për ambalazhin, që përdoret për transportin e materialeve radioaktive, jepet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

2. Miratimi për ambalazhin, që përdoret për transportin e materialeve bërthamore, jepet nga Agjencia Kombëtare Bërthamore.

3. Ministria që mbulon çështjet e tregtisë është përgjegjëse për vendosjen për herë të parë në treg dhe kryerjen e inspektimeve, periodike apo të ndërmjetme, dhe kontrollet jashtë radhe të pajisjeve nën presion të transportueshme, në përputhje me ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e ADR-së ose RID-it.

4. Certifikata për rivlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion lëshohet nga organi i miratuar nga ministri që mbulon çështjet e tregtisë, në përputhje me ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me ligjin nr. 8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”, dhe në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

5. Institucionet, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, japin miratimin për përdorimin e ambalazheve, vetëm kur ato janë në përputhje me ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

6. Institucionet, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, marrin si bazë për dhënien e miratimit edhe rezultatet e testimit nga një organ i miratuar nga autoriteti kompetent i një shteti tjetër, i cili plotëson kushtet e ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe dispozitat e ADR-së ose RID-it.

7. Ambalazhi, i cili është i miratuar nga organi i miratuar nga shteti tjetër, pranohet vetëm nëse është testuar dhe miratuar në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

8. Kushtet, procedurat e rregullat për dhënien dhe heqjen e miratimit për ambalazhet nga institucionet përgjegjëse, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 10

##### **Shenjat e ambalazhit**

1. Ambalazhi miratohet me shenjat e përcaktuara në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it. Nuk lejohet përdorimi i shenjave, të cilat shkaktojnë keqkuptime me shenjat e miratuara më parë ose me shenjat e vendeve të tjera.



2. Për arsye të sigurisë në transport, nëse është përcaktuar në dispozitat e ADR-së ose RID-it, në ambalazhe vendosen shenja me kufizimet e nevojshme, në lidhje me përdorimin e ambalazhit.

#### Neni 11

#### **Heqje miratimit për ambalazhin**

1. Në rastet kur organet e mbikëqyrjes së tregut, të ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi, konstatojnë se ambalazhi nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe dispozitat e ADR-së ose RID-it, ndalojnë përdorimin e tij për transportin e mallrave të rrezikshme dhe njoftojnë menjëherë institucionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 9 të këtij ligji.

2. Institucionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 9 të këtij ligji fillojnë menjëherë procedurat për heqjen e miratimit për ambalazhin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 12

#### **Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme**

1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoret mjete:

- a) që është i prodhuar dhe i pajisur në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;
- b) për të cilin ka një certifikatë të vlefshme të miratimit, sipas ADR-së, për transportin e disa mallrave të rrezikshme, kur një gjë e tillë specifikohet në dispozitat e ADR-së ose RID-it;
- c) që është i pajisur me panele (pllakata) dhe është i shënuar në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

2. Ndalohet përdorimi i shenjave, si pllakate, shenja paralajmëruese, etiketa, të cilat përdoren për të treguar rrezikshmërinë, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së ADR-së ose RID-it, mbi paketat ose mbi mjetet e transportit që nuk kryejnë transport të mallrave të rrezikshme.

#### Seksioni II

#### **Pjesëmarrësit në transport**

#### Neni 13

#### **Detyrimet e pjesëmarrësve në transport**

1. Pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme marrin të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me natyrën dhe shtrirjen e parashikuar të rreziqeve, për reduktimin ose shmangien e dëmeve në njerëz, në pronë dhe në mjedis. Ata përbushin, në të gjithë rastet, kërkesat e dispozitave të ADR-së ose RID-it në fushat e tyre përkatëse.

2. Në rastin e një rreziku serioz ose aksidenti të menjëhershëm, ku siguria e publikut, pronës dhe mjedisit rrezikohet, pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme njoftojnë menjëherë Qendrën Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile, duke vënë në dispozicion të saj të gjithë informacionin e nevojshëm për ndërmarrjen e veprimeve.

3. Në rastin e një aksidenti ose incidenti gjatë veprimtarisë së ngarkimit, mbushjes, transportit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme, ngarkuesi, mbushësi, transportuesi, shkarkuesi ose marrësi, përkatësisht për fushën që mbulojnë, përgatitin një raport për aksidentin ose incidentin në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, të cilin ia paraqesin ministrisë. Forma dhe përmbajtja e modelit të raportit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4. Dërguesi, transportuesi dhe marrësi bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me personat e tjerë të autorizuar të autoriteteve shtetërore në shkëmbimin e informacionit, me qëllim rritjen e sigurisë për masat parandaluese dhe procedurat që duhet të ndiqen në rastin e aksidenteve dhe incidenteve.



## Neni 14 Dërguesi

1. Dërguesi i mallrave të rrezikshme është subjekti, i cili është i identifikuar në dokumentacionin e transportit si dërgues i mallrave.
2. Dërguesi dorëzon mallra të rrezikshme për transport, vetëm nëse:
  - a) mallrat janë në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;
  - b) autorizimi për transportin e mallrave të rrezikshme është lëshuar, kur kërkohet autorizim në bazë të neneve 23, 26 e 27 të këtij ligji;
  - c) mallrat janë të vendosura në ambalazh që i përmbush kërkesat e nenit 7 të këtij ligji;
  - ç) mallrat janë në përputhje të plotë me kushtet e transportit, ngarkimit të përzier, trajtimit, ruajtjes, pastrimit dhe dekontaminimit, si dhe dispozitat e tjera të ADR-së ose RID-it;
  - d) mjetet janë në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji;
  - dh) drejtuesi i mjetit apo subjekti, i cili kryen transportin, është i pajisur me dokumentet e nevojshme shoqëruese, të paraqitura në bazë të dispozitave të përmendura në ADR ose RID dhe, nëse është e nevojshme, autorizimin për transport, në përputhje me nenet 23, 26 e 27 të këtij ligji;
  - e) ai zbaton masa të tjera sigurie, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji.
3. Kur dërguesi përdor shërbime të pjesëmarrësve të tjerë (paketuesin, ngarkuesin, mbushësin etj.), ai merr masa të përshtatshme për të garantuar që dërgesa plotëson dispozitat e ADR-së ose RID-it. Për rastin e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, dërguesi bazohet në informacionin dhe të dhënat që i ofrojnë pjesëmarrësit e tjerë në transport.
4. Kur dërguesi vepron në emër të një pale të tretë, kjo e fundit informon dërguesin me shkrim për mallrat e rrezikshme, të cilat janë përfshirë, dhe i dërgon atij të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e detyrimeve të tij.

## Neni 15 Transportuesi

1. Transportuesi transporton mallra të rrezikshme vetëm nëse:
  - a) për këto mallra të rrezikshme, që ai do të transportojë, janë dhënë autorizimet përkatëse për transport në bazë të ADR-së ose RID-it, si dhe ato janë të shoqëruara me dokumentacionin këshillues, i cili ndodhet në bordin e njësisë së transportit;
  - b) ai është i pajisur me një autorizim për transportin e mallrave të rrezikshme, për të cilat kërkohet autorizimi, sipas nenit 23 ose 26 apo 27 të këtij ligji;
  - c) mallrat e rrezikshme janë të paketuara në ambalazhe, sipas kërkesave të nenit 7 të këtij ligji, si dhe mbi to janë fiksuar etiketat e rrezikshmërisë dhe shënimet përshkruese për mjetet;
  - ç) janë përmbushur kushtet për mënyrën e transportit, ngarkimin e përbashkët, trajtimin e sigurimit e mallrave të rrezikshme dhe pastrimin, degasifikimin e dekontaminimin e enëve ku vendosen mallrat, si dhe dispozitat e tjera, në bazë të ADR-së ose RID-it;
  - d) mjeti përmbush kërkesat e nenit 12 të këtij ligji dhe është teknikisht në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;
  - dh) mjeti ngarkohet siç duhet dhe në përputhje me nivelet maksimale të lejuara për mallrat e rrezikshme, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji;
  - e) mjeti është i pajisur me dokumentin e sigurimit të përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë fushë.
  - ë) ai respekton masa të tjera sigurisë, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it dhe me rregullat e tjera që rregullojnë sigurinë në transport.

2. Transportuesi, për rastin e shkronjave “a”, “c” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni, bazohet në informacionin e dhënë nga pjesëmarrësit e tjerë.

3. Nëse transportuesi konstaton një shkelje të kërkesave të dispozitave të ADR-së ose RID-it, ai nuk e nis ngarkesën derisa çështja të sqarohet.

#### Neni 16

##### **Marrësi**

1. Marrësi i ngarkesës ka për detyrë të mos shtyjë afatin e pranimit të mallrave pa ndonjë arsye detyruese dhe të verifikojë, pas shkarkimit, nëse janë plotësuar kërkesat e ADR-së ose RID-it.

2. Nëse marrësi i ngarkesës përdor shërbime të pjesëmarrësve të tjerë, si shkarkues, pastrues, dekontaminues etj., ai merr masa të përshtatshme që të garantojë plotësimin e përcaktimit të bërë në pikën 1 të këtij neni dhe të kërkesave të tjera të ADR-së ose RID-it.

#### Neni 17

##### **Ngarkuesi dhe shkarkuesi**

1. Ngarkuesi kryen detyrimet si më poshtë:

a) dorëzon mallra të rrezikshme te transportuesi vetëm nëse ato janë në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;

b) kontrollon ambalazhin gjatë dorëzimit për transportin e mallrave të rrezikshme të ambalazuara ose ambalazhet bosh të papastrat. Ai nuk dorëzon paketën, ambalazhi i së cilës është i dëmtuar, veçanërisht nëse nuk i është kryer prova e hermeticitetit ose ka rrjedhje apo ka mundësi rrjedhjeje të substancës së rrezikshme, derisa dëmtimi të jetë riparuar. Ky detyrim, gjithashtu, zbatohet tek ambalazhet bosh e të papastrat;

c) përmbush kërkesat e veçanta në lidhje me ngarkimin ose trajtimin, kur ngarkon mallrat e rrezikshme në një mjet ose në një konteiner;

ç) plotëson kërkesat në lidhje me shenjat e rrezikut, si pllakatet ose pllakën portokalli mbi mjet ose mbi konteiner, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;

d) zbaton ndalimet për ngarkesat e përziera, duke marrë parasysh mallrat e rrezikshme në mjet ose në konteiner dhe zbaton kërkesat, në lidhje me ndarjen e ushqimeve ose artikujve të tjerë të konsumit apo ushqimet e kafshëve.

2. Shkarkuesi kryen detyrimet si më poshtë:

a) konstaton që mallrat e rrezikshme shkarkohen duke krahasuar informacionin përkatës, të vendosur në dokumentet e transportit, me informacionin mbi paketa, konteiner, cisternë ose mjete;

b) para dhe gjatë shkarkimit, kontrollon nëse ambalazhet, cisternat, mjete ose konteineri është dëmtuar në një nivel, i cili do të rrezikonte operacionin e shkarkimit. Në këtë rast, shkarkimi nuk kryhet derisa të ndërmerren masat e duhura;

c) siguron pastrimin dhe dekontaminimin e mjeteve ose konteinerëve;

ç) siguron që konteinerët pas shkarkimit komplet, të pastruar dhe të dekontaminuar, nuk mbajnë më shenjën e rrezikut, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

3. Subjektet e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni plotësojnë masat e tjera të sigurisë, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, në lidhje me ngarkimin ose shkarkimin.

4. Nëse marrësi i ngarkesës përdor shërbime të pjesëmarrësve të tjerë, si shkarkues, pastrues, dekontaminues etj., ai merr masa të përshtatshme që të garantojë plotësimin e kërkesave të tjera të ADR-së ose RID-it.



### Neni 18 **Ambalazhuesi**

Ambalazhuesi kryen detyrimet si më poshtë:

- a) plotëson kërkesat në lidhje me kushtet e ambalazhimit ose kushtet e ambalazhimit të përzier;
- b) plotëson kushtet në lidhje me shenjat paralajmëruese dhe etiketat e paketave;
- c) respekton masat e tjera të sigurisë në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

### Neni 19 **Mbushësi**

Mbushësi kryen detyrimet si më poshtë:

- a) para fillimit të mbushjes me substanca të rrezikshme të cisternave, ai vlerëson që cisternat dhe pajisjet e tyre janë në gjendje teknike të mirë dhe konstaton që data e testimit të ardhshëm nuk ka përfunduar;
- b) mbush cisternat vetëm me mallra të rrezikshme të autorizuara për transportim në ato cisterna;
- c) gjatë mbushjes së cisternës, plotëson kërkesat, në lidhje me mallrat e rrezikshme në ndarjet (dhomat) që janë ngjitur me njëra-tjetrën (fqinje);
- ç) gjatë mbushjes së cisternës, vëzhgon nivelin e lejuar maksimal të mbushjes ose masën e lejuar maksimale të përmbajtjes për litër të kapacitetit për substancën që është duke u mbushur;
- d) kontrollon, pas mbushjes, pajisjet e shkarkimit të cisternës për hermeticitet;
- dh) sigurohet që nuk ka mbetje të substancës që mbushi në sipërfaqen e jashtme të cisternës së mbushur prej tij;
- e) sigurohet që pllaka ngjyrë portokalli dhe panelet ose etiketat janë të fiksuara në cisternë, mbi mjet e konteiner;
- ë) gjatë mbushjes së mjeteve ose konteinerëve me mallra të rrezikshme të ngurta sigurohet se ka vepruar në përputhje me dispozitat e ADR-së apo RID-it;
- f) zbaton masa të tjera të sigurisë, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

### Neni 20 **Operatori i konteinerit-cisternë ose cisternës së transferueshme dhe i vagonit-cisternë**

Operatori i cisternës-konteiner ose i cisternës së transferueshme dhe i vagonit-cisternë ka detyrimet si më poshtë:

- a) të garantojë plotësimin e kërkesave për konstruksionin, pajisjen, testimin dhe shenjzimin e konteinerit-cisternë ose të cisternës së transferueshme dhe të vagonit-cisternë, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it;
- b) të sigurojë mirëmbajtjen e cisternave dhe pajisjeve të tyre për të garantuar përputhjen me përcaktimin e shkronjës “a” të këtij neni, deri në kohën e inspektimit teknik pasues;
- c) të kryejë një inspektim teknik jashtë radhe (të veçantë) të sigurisë së cisternës për të garantuar përputhjen me përcaktimin e shkronjës “a” të këtij neni, si pasojë e ndonjë dobësimi nga një riparim ose nga një ndryshim apo nga një aksident, të cilët të gjithë ndikojnë në sigurinë e cisternës;
- ç) të zbatojë masa të tjera të sigurisë, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.

## Neni 21

### **Detyrimet e transportuesit në rast humbjeje të mallit**

1. Transportuesi duhet të marrë të gjitha masat e duhura, me qëllim shmangien e humbjes së pjesshme ose të të gjitha mallrave të rrezikshme gjatë transportit. Në rast konstatimi, ai duhet të informojë menjëherë Qendrën Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile për llojin dhe sasinë e mallrave të rrezikshme, si dhe për shkallën e rrezikut që ato paraqesin për dëmtimin e njerëzve, pronës dhe mjedisit.

2. Në rastin e aksidenteve ose incidenteve në transport të substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore, përveç Qendrës Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile duhet të njoftohen edhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore.

3. Për ngjarjet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, pjesëmarrësit në transport përgatisin një raport, në përputhje me pikën 3 të nenit 13 të këtij ligji.

## Neni 22

### **Masat që merren në rast derdhjeje apo rrjedhjeje të mallrave të rrezikshme**

1. Në rast derdhjeje apo rrjedhjeje të mallrave të rrezikshme, transportuesi merr masat e nevojshme për mbledhjen ose heqjen e tyre, duke i bërë ato të padëmshme dhe njofton menjëherë Qendrën Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile.

2. Nëse transportuesi nuk është në gjendje të përmbushë vetë detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ai mund të përdorë për këto shërbime personin juridik ose fizik, i cili është i autorizuar të veprojë në rastin e aksidenteve apo incidenteve me mallrat e rrezikshme. Shpenzimet për shërbime të tilla janë për llogari të transportuesit.

3. Në rastin e një dëmi të shkaktuar në mjedis, transportuesi përcakton masat e nevojshme rehabilituese të mjedisit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 50 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të cilat ia paraqet për miratim Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Gjatë përcaktimit të masave rehabilituese, transportuesi merr parasysh që këto masa të jenë të përshtatshme dhe efikase për eliminimin e të gjithë dëmit që i është shkaktuar mjedisit.

4. Artikujt ose mallrat e rrezikshme të derdhura ose që kanë rrjedhur apo objektet e kontaminuara duhet të neutralizohen sipas rregullave të veçanta.

5. Për ngjarjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pjesëmarrësit në transport përgatisin një raport, në përputhje me pikën 3 të nenit 13 të këtij ligji.

## Seksioni III

### **Autorizimet në transport**

## Neni 23

### **Llojet e mallrave për autorizim**

1. Transporti i mallrave të rrezikshme, si lëndët plasëse, lëndët radioaktive e materialet bërthamore, kryhet me autorizim.

2. Autorizimi për transportin e:

a) lëndëve plasëse lëshohet nga Ministria e Brendshme dhe, me lëshimin e këtij autorizimi, kryhet njoftimi për komisaritet e policive të rretheve, përmes të cilave kalon itinerari i udhëtimit;

b) materialeve radioaktive lëshohet nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR);

c) materialeve bërthamore lëshohet nga Agjencia Kombëtare Bërthamore.



3. Si përjashtim nga pika 2 e këtij neni, autorizimi për transportin e brendshëm për lëndët plasëse dhe materialet bërthamore e radioaktive nuk është i nevojshëm vetëm në rastin kur kryhet në përputhje me përjashtimet e parashikuara në dispozitat e ADR-së ose RID-it. Për lëndët plasëse, transportuesi informon 24 orë para Drejtorinë e Policisë së Shtetit, e cila informon të gjitha komisarariatet e policisë së rretheve për vendin e fillimit, të kalimit e të përfundimit të udhëtimit. Në këtë informacion përcaktohen koha e saktë e fillimit të operacionit të transportit dhe koha e përafërt, e parashikuar, e përfundimit të këtij operacioni.

4. Subjektit, veprimtaria e të cilit është e lidhur me përdorimin e lëndëve plasëse ose radioaktive, mund t'i jepet autorizim për transporte të shumëfishta të këtyre substancave, i cili është i vlefshëm për një muaj për lëndët plasëse dhe deri në gjashtë muaj për substancat radioaktive. Një autorizim i tillë jepet vetëm nëse plotësohet kushti që transporti të kryhet në të njëjtën ditë të javës, në të njëjtën orë, në të njëjtin itinerar nga origjina në destinacion, me të njëjtin mjet/mjete transporti dhe me të njëjtin drejtues mjete.

5. Parashtruesi i kërkesës për autorizim, sipas këtij neni, duhet të vendosë kohën e saktë të fillimit dhe kohën e parashikuar të përfundimit të transportit dhe të informojë 24 orë para Drejtorinë e Policisë së Shtetit, e cila informon komisarariatet e policisë së rretheve, ku do të fillojë transporti i lëndëve plasëse, ose organin e policisë kufitare të pikës, ku kryhen importimi, eksportimi ose kalimi transit i lëndëve plasëse, ndërsa, në rastin e substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore, ai duhet të njoftojë edhe institucionin që ka lëshuar autorizimin.

#### Neni 24

#### **Kërkesa për autorizim**

1. Kërkesa për një autorizim për transportin e mallrave, në përputhje me pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji, paraqitet nga dërguesi ose transportuesi apo marrësi dhe përmban elementet e mëposhtme:

- a) informacion rreth prodhuesit, dërguesit, transportuesit dhe marrësit të ngarkesës;
- b) numrin UN të mallrave të rrezikshme dhe të dhënat që konfirmojnë përputhjen me dispozitat të caktuara të ADR-së ose RID-it;
- c) të dhënat për llojin, emrin teknik, sasinë, mënyrën e ambalazhimit dhe përbërjen kimike e fizike të mallrave të rrezikshme;
- ç) hartën me itinerarin e lëvizjes;
- d) vendin e shkarkimit;
- dh) afatin, brenda të cilit do të kryhet transporti, i cili nuk duhet t'i kalojë 15 ditë nga data e dorëzimit të mallrave të transportuesit;
- e) informacionin rreth mjetit dhe drejtuesit të transportit të mallrave me rrugë;
- ë) autorizimin e autoriteteve përgjegjëse të shtetit fqinj, i cili lejon importimin ose transitimin.

2. Kur aplikohet për autorizimin e posaçëm për transportin e shumëfishtë, sipas pikës 4 të nenit 23 të këtij ligji, nuk është e nevojshme të jepen specifikimet, sipas shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni.

#### Neni 25

#### **Kërkesa sigurie shtesë për lëshimin e një autorizimi**

1. Organi përgjegjës për lëshimin e autorizimit mund të vendosë kushte shtesë për transportin ose masa sigurie të posaçme për mbrojtjen e njerëzve, mjedisit, pronës ose për të mbrojtur transportin nga persona të paautorizuar.

2. Shpenzimet për kushtet shtesë ose masat e veçanta mbulojnë nga personi fizik ose juridik, që ka aplikuar për autorizim.

Neni 26  
**Autorizimi i veçantë**

1. Transporti i mallrave të rrezikshme, që nuk janë të përfshira në dispozitat e ADR-së ose RID-it, ose për qëllime të testimi apo për arsye të novacionit teknologjik ose për raste të veçanta, kur transporti i mallrave të rrezikshme është i ndaluar apo kur kryhet në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara në dispozitat e ADR-së ose RID-it, kryhet me autorizim të veçantë, të lëshuar nga ministri, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

2. Komiteti Ndërmintor për Transportin e Mallrave të Rrezikshme përcakton, rast pas rasti, kriteret për përfitim të një autorizimi të veçantë, sipas pikës 1 të këtij neni, me kusht që siguria në transport të mos cenohet.

3. Për këtë qëllim, të interesuarit për marrjen e një autorizimi të tillë duhet t'i dorëzojnë institucionit përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij neni, një kërkesë të shoqëruar me një studim teknik për të justifikuar operacionin e transportit.

4. Autorizimi, sipas pikës 1 të këtij neni, lëshohet për një afat të caktuar.

Neni 27  
**Kufizimet**

1. Subjekti transportues që përdor itinerarin e përcaktuar të rrugëve ose rrugëve urbane, tunelet e urat, të cilat janë objekt i kufizimeve ose ndalimeve për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, ose është objekt i dispozitave të tjera shtesë, në përputhje me ADR-në, duhet të kërkojë një autorizim të veçantë nga organi përkatës administrativ, duke paraqitur të dhëna për kalendarin, planifikimin e orareve, itinerarin, nevojat për shoqërim, nëse ka, dhe rrethanat e tjera specifike, në përputhje me rregullat e qarkullimit.

2. Organi përkatës administrativ, i cili lëshon autorizimin e veçantë, në çdo rast, është i detyruar të njoftojë ministrinë për procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni IV  
**Procedurat për këshilltarin e sigurisë dhe pjesëmarrësit në transportin  
e mallrave të rrezikshme**

Neni 28  
**Caktimi i këshilltarit të sigurisë**

1. Subjekti, i cili në veprimtarinë e tij përfshin transportin ose veprimtarinë e lidhura me ambalazhimin (paketimin), ngarkimin, mbushjen ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme, cakton, zyrtarisht, një ose më shumë këshilltarë të sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, për parandalimin e rreziqeve të qenësishme në veprimtari të tilla ndaj njerëzve, pronës dhe mjedisit.

2. Subjekti i përmendur në pikën 1 të këtij neni njofton, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e caktimit, ministrinë për identitetin e këshilltarit të sigurisë, si dhe për çdo ndryshim të mundshëm që ka lidhje me këtë person.

3. Subjekti cakton për këshilltar të sigurisë çdo person, i cili është mbajtës i një certificate të vlefshme të formimit profesional të tij.

4. Procedurat dhe kriteret për njohjen e certifikatave të lëshuara nga organet e caktuara në një shtet tjetër, palë kontraktuese në marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij neni nuk kanë detyrim të caktojnë këshilltarë të sigurisë, nëse në çdo mjet ndodhen sasi më të vogla se ato të specifikuara në dispozitat e ADR-së ose RID-it.



## Neni 29

### Detyrat e këshilltarit të sigurisë

1. Detyrat e këshilltarit të sigurisë, në lidhje me veprimtarinë e subjektit, janë:
  - a) monitorimi për respektimin e dispozitave që rregullojnë transportin e mallrave të rrezikshme;
  - b) këshillimi i subjektit të tij për transportin e mallrave të rrezikshme;
  - c) përgatitja e një raporti vjetor për menaxhimin e veprimtarisë së subjektit për transportin e mallrave të rrezikshme, të cilin ia dërgon ministrisë brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës. Ky raport ruhet për 5 vjet nga subjekti dhe është i disponueshëm për ministrinë e institucionet e tjera të interesuara, të ngarkuara me ligj, sa herë kërkohen prej tyre;
  - ç) këshillimi i punonjësve të tjerë të subjektit dhe mirëmbajtja e dosjeve për këshillimin e tyre;
  - d) zbatimi i masave të përshtatshme për të shmangur përsëritjen e aksidenteve, incidenteve ose shkeljeve serioze që kanë ndodhur më parë;
  - dh) marrja e masave të duhura në rastin e ndonjë aksidenti ose incidenti që mund të ndikojë në sigurinë gjatë transportit, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme;
  - e) kontrolli, nëpërmjet të cilit realizohet verifikimi i pajisjeve të përdorura në lidhje me transportin, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme;
  - ë) zbatimi i procedurave të verifikimit, me qëllim që në bordin e mjetit të transportit të jenë dokumentet dhe pajisjet e sigurisë që duhet të shoqërojnë transportin dhe që këto dokumente e pajisje të jenë në përputhje me rregullat.
2. Detyrat e këshilltarit të sigurisë për monitorimin e praktikave dhe procedurave, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të subjektit, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## Neni 30

### Raportet në rastin e aksidenteve

1. Kur ndodh një aksident me pasojë dëme në persona, pronë ose mjedis, gjatë kryerjes së ngarkimit, mbushjes, transportit ose shkarkimit, këshilltari i sigurisë, pas mbledhjes së të gjithë informacionit përkatës, përgatit raportin e aksidentit për drejtimin dhe administrimin e subjektit.
2. Raporti i aksidentit, i përgatitur sipas pikës 1 të këtij neni, ruhet nga subjekti për 5 vjet dhe është i vlefshëm për personat e autorizuar për kontroll, sipas nenit 39 të këtij ligji, për ministrinë e interesuara ose institucionet e tjera të ngarkuara me ligj, sa herë kërkohet prej tyre.
3. Raporti i aksidentit nuk zëvendësohet me raportin periodik vjetor, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji, i cili mund të kërkohet në bazë të një legjislacioni tjetër kombëtar ose ndërkombëtar.
4. Organet e mbikëqyrjes dhe ato inspektuese, sipas nenit 51 të këtij ligji, për çdo rast, caktojnë një ose disa persona për të hetuar rrethanat, në të cilat ka ndodhur një incident ose aksident, me pasojë dëme në persona, pronë ose mjedis ose çdo veprimtari tjetër që ka lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, e të parashikuar në dispozitat e këtij ligji.
5. Personi ose personat e caktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, hartojnë një raport, të cilin ia paraqesin ministrit dhe Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror ose titullarit të organit mbikëqyrës përkatës, kur ai nuk është inspektorat shtetëror, sipas nenit 51 të këtij ligji.



Neni 31

**Trajnimi profesional i këshilltarit të sigurisë**

1. Ministri, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, përcakton, me udhëzim, programin e formimit profesional, mënyrën e trajnimit dhe vlerësimit të këshilltarëve të sigurisë.

2. Ministri, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, përcakton, me udhëzim, formën dhe vlefshmërinë e certifikatës së kualifikimit të këshilltarëve të sigurisë, e përmendur në pikën 3 të nenit 28 të këtij ligji, përmbajtjen dhe mënyrën e kryerjes së provimeve, listën e lëndëve ose çështjeve që duhet të trajtohen dhe përbërjen e komisionit të caktuar për kryerjen e provimit. Tarifat për trajnimin dhe provimin e këshilltarëve të sigurisë përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

3. Ministri, në fillim të çdo viti kalendarik, me propozim të Komitetit Ndërmintor për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, sipas pikës 1 të nenit 53 të këtij ligji, emëron anëtarët e komisionit të provimit.

4. Për punën e kryer, sipas pikës 1 të këtij neni, anëtarët e komisionit shpërblehen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Trajnimi profesional i këshilltarëve të sigurisë kryhet nga institucioni i licencuar nga ministri për këtë qëllim. Kriteret për licencimin e institucioneve të trajnimit të këshilltarëve të sigurisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

**Trajnimi profesional i personave të përfshirë në transport**

1. Personat e punësuar nga pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme duhet të kenë, të paktën, arsimin e mesëm, të kenë përfunduar programin e trajnimit profesional, në varësi të detyrave dhe përgjegjësisive të pozicionit që kanë në punë, dhe të kenë kaluar provimin e formimit profesional.

2. Trajnimi profesional i personave, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe shtrirja e njohurive të tyre për sigurinë e operacioneve të rëndësishme që ata kryejnë është periodik në raste të parashikuara, me qëllim rifreskimit e njohurive dhe kontrollet ndaj tyre janë të paparalajmëruara. Dokumentacioni për trajnimin e çdo punonjësi mbahet nga punëdhënësi në dosjen personale të çdo punëmarrësi, si dhe nga vetë punëmarrësi.

3. Kushtet, procedurat e rregullat për trajnimin, provimin dhe vlefshmërinë e certifikatave për personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, miratohen me udhëzimin e ministrit.

4. Trajnimi profesional i personave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni kryhet nga institucioni i licencuar nga ministri për këtë qëllim. Kriteret për licencimin e këtyre institucioneve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Tarifat për trajnimin dhe provimin e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

**KREU III**

**DISPOZITA TË VEÇANTA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE  
TË RREZIKSHME ME RRUGË**

Neni 33

**Detyrimet e transportuesit**

1. Transportuesi duhet të plotësojë kushtet e nenit 12 të këtij ligji për mjetin, i cili përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme.



2. Për transportin e mallrave të rrezikshme, transportuesi lejon vetëm drejtues mjeti të kualifikuar për këtë lloj transporti, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

#### Neni 34

#### **Detyrimet e dërguesit**

1. Dërguesi i mallrave të rrezikshme me rrugë, përveç detyrimeve të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, duhet të plotësojë edhe detyrimet e mëposhtme:

- a) informon transportuesin për panelet dhe shenjat që duhet të vendosen mbi mjet;
- b) informon transportuesin për mallrat e rrezikshme;
- c) shënon paketat me shenjat paralajmëruese, mbishkrimet dhe etiketat me shenjat e rrezikut.

2. Kushtet, procedurat e rregullat e hollësishme për detyrime të tjera të dërguesit, në përputhje me dispozitat e ADR-së, miratohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 35

#### **Kushtet dhe detyrimet e drejtuesit të mjetit**

1. Drejtuesi i mjetit ushtron detyrën e tij si drejtues i një mjeti që transporton mallra të rrezikshme, në qoftë se:

a) ka mbushur moshën 21 vjeç dhe ka drejtuar, të paktën për një vit, një mjet me masë maksimale që i kalon 3,5 tonë;

b) është i pajisur me certifikatën e kualifikimit, në përputhje me dispozitat e ADR-së.

2. Drejtuesi i mjetit, gjatë ushtrimit të detyrës, duhet që:

a) para nisjes të njihet me mallrat e rrezikshme të ngarkuara dhe të konsultojë instruksionin me shkrim për të gjitha hollësitë e operacionit të transportit dhe veprimet që duhet të ndërmarrë në rast aksidenti ose emergjence;

b) të verifikojë nëse mjeti, mallrat e rrezikshme dhe ngarkesa plotësojnë standardet e kërkuara në dispozitat e ADR-së;

c) të verifikojë nëse paketat dhe mjeti janë shënuar me shenjat përkatëse paralajmëruese, mbishkrimet dhe etiketat me shenjen e rrezikut dhe mjeti është i pajisur me informacione të tjera, në lidhje me mallrat e rrezikshme dhe mjetin, në përputhje me dispozitat e ADR-së;

ç) të zotërojë dokumentin e sigurimit të përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) të zotërojë dokumente dhe pajisje, në përputhje me dispozitat e ADR-së;

dh) të plotësojë kërkesat e tjera për transportin, në përputhje me dispozitat e ADR-së.

3. Çdo person, që shoqëron drejtuesin e mjetit gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 36

#### **Masat e sigurisë**

1. Drejtuesi i mjetit gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe transportit të mallrave të rrezikshme duhet të zbatojë masat e sigurisë, në përputhje me dispozitat e ADR-së.

2. Drejtuesi i mjetit, gjatë transportit, duhet të zbatojë dispozitat e ADR-së dhe pikat 3 e 4 të këtij neni.

3. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për çështjet e brendshme dhe ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, me udhëzim, përcaktojnë vendet e parkimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme dhe kushtet që duhet të përmbushin këto vend-parkime.

4. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për çështjet e brendshme dhe ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, me udhëzim, vendosin kufizime për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugët publike.

#### Neni 37

##### **Inspektimi i mjetit**

1. Konformiteti i mjeteve për transportin e disa mallrave të rrezikshme, sipas nenit 12 të këtij ligji, është subjekt i certifikatës së miratimit ADR, e cila lëshohet nga personi juridik, i autorizuar nga ministri.

2. Personi juridik i përmendur në pikën 1 të këtij neni kryen inspektimin e mjeteve, përpunimin e dokumenteve dhe lëshimin e certifikatës së miratimit ADR për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme, në përputhje me dispozitat e ADR-së.

3. Inspektimi i mjetit për qëllime të përpunimit të dokumentacionit, në bazë të të cilit lëshohet certifikata e miratimit ADR për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet nga inspektuesit teknikë, të cilët zotërojnë të paktën diplomën e arsimit të lartë të inxhinierisë mekanike.

Personi juridik i licencuar nga ministri, sipas pikës 1 të këtij neni, ka personel të trajnuar ose ka të drejtën e trajnimit të personelit, që kryen inspektimin e mjeteve të transportit të disa mallrave të rrezikshme.

4. Përpunimi vetëm i dokumentacionit, në bazë të të cilit lëshohet certifikata e miratimit ADR për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryhet nga persona që kanë përfunduar të paktën arsimin e shkollës së mesme të përgjithshme ose shkollës së mesme mekanike për transport.

5. Procedurat dhe vendet për inspektimin e mjeteve që transportojnë disa mallra të rrezikshme dhe lëshimi i certifikatës së miratimit ADR për mjetet për transportin e disa mallrave të rrezikshme, në përputhje me dispozitat e ADR-së, si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga personi juridik i përmendur në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

6. Tarifat për inspektimin e mjetit për transportin e mallrave të rrezikshme përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 38

##### **Trajnimi profesional i drejtuesve të mjeteve**

1. Drejtuesit e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të jenë të pajisur me një certifikatë të vlefshme kualifikimi.

2. Certifikata e kualifikimit lëshohet pasi drejtuesi i mjetit i është nënshtruar një kursi trajnimi dhe pasi ka kaluar një provim për kërkesat e veçanta që duhet të plotësohen gjatë transportit të mallrave të rrezikshme. Trajnimi dhe provimi për drejtuesit e mjeteve kryhen nga institucioni i licencuar nga ministri për këtë qëllim. Kriteret për licencimin e këtyre institucioneve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Programi, mënyra e trajnimit dhe provimit të aftësisë profesionale të drejtuesve, në përputhje me dispozitat e ADR-së, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4. Forma, përmbajtja, vlefshmëria e certifikatave, mënyra dhe procedura për lëshimin e certifikatës së drejtuesit, në përputhje me dispozitat e ADR-së, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Institucioni i licencuar, sipas pikës 2 të këtij neni, mban në një regjistër të veçantë të dhënat për çdo kurs trajnimi të miratuar, për çdo person të trajnuar dhe të testuar, si dhe çdo certifikatë kualifikimi të lëshuar, për një periudhë, e cila përcaktohet me udhëzimin e ministrit.

6. Tarifat për trajnimin dhe provimin e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.



### Neni 39

#### **Kontrolli në rrugë**

1. Shërbimet e kontrollit në rrugë të mallrave të rrezikshme kryhen nga personat e autorizuar të organeve të Policisë Rrugore dhe të inspektoratit të kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Nëse gjatë ushtrimit të detyrës kërkohen njohuri specifike, në shërbimet e kontrollit në rrugë përfshihen inspektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorët e shërbimeve përkatëse dhe, kur është e nevojshme e kur nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi, mund të merren organizata ose individë të specializuar. Kontrollët në rrugë janë të rastësishme dhe shtrihen në të gjithë rrjetin rrugor.

2. Gjatë ushtrimit të kontrollit, personi i autorizuar për kontroll, kur është e përshtatshme dhe me kusht që të mos përbëjë rrezik për sigurinë, mund të marrë mostra të mallrave të rrezikshme për qëllime testimi, klasifikimi, kërkimi dhe zhvillimi të teknologjisë, kontrolli cilësor ose për ta marrë si një mostër tregtare.

3. Me kërkesën e personit të autorizuar për kontroll, drejtuesi i mjetit është i detyruar të paraqesë dokumentacionin, në lidhje me mjetin e mallrat e rrezikshme që transporton, si dhe çdo dokument tjetër ose informacion që i kërkohet për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e ADR-së.

4. Përmbajtja dhe forma e procesverbalit për mostrat e mallrave të rrezikshme, të përmendura në pikën 2 të këtij neni, janë në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Personi i autorizuar për kontroll, pas kryerjes së kontrollit, ia jep një kopje të listës së kontrollit ose dokumentit që tregon rezultatet e kontrollit drejtuesit të mjetit, i cili e paraqet atë sa herë kërkohet për kontrole të mëtejshme nga personat e autorizuar. Përmbajtja dhe forma e listës së kontrollit dhe e dokumentit caktohen me udhëzim të ministrit.

6. Nëse personi i autorizuar për kontroll e gjykon të arsyeshme se mjeti ka nevojë për një inspektim ose testim të mëtejshëm, ai shoqëron mjetin në një vend të sigurt e të përshtatshëm, të caktuar nga ai, ku riparohen defektet e identifikuar, që mund të sjellin rrezik të sigurisë. Në këtë rast, lejohet që udhëtimi i mjetit të kryhet në rrugë sa më të përshtatshme për mënjanimin e cenimit të sigurisë në rrugë dhe, për këto raste, shpenzimet janë të pronarit ose drejtuesit të mjetit.

7. Masat e marra nga personi i autorizuar për kontroll, sipas pikës 6 të këtij neni, përbëjnë masa urgjente dhe, si të tilla, për ato veprohet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

### Neni 40

#### **Ndalimi i përkohshëm ose ndërprerja e transportit**

1. Nëse personat e autorizuar për kontroll konstatojnë shkelje të rregullave të qarkullimit, të specifikuar në listën e përmendur në pikën 3 të nenit 45 të këtij ligji, mund të pezullojnë vazhdimin e mëtejshëm të transportit dhe të marrin masa për rregullimin e të metave ose të zbatojnë masa të tjera të përcaktuara. Të metat rregullohen në vend, nëse ato nuk përbëjnë rrezik për sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit. Personat e autorizuar për kontroll vendosin masën e dënimit në vend, pasi kanë sqaruar drejtuesin për shkeljen e konstatuar dhe drejtuesi është i detyruar të rregullojë të metat dhe pastaj mund të vazhdojë udhëtimin.

2. Gjatë ndalimit të përkohshëm të transportit, mjeti mund të lëvizë vetëm sipas udhëzimeve të personave të autorizuar për kontroll. Në rastin e një shkeljeje të mundshme të dispozitave të ndalimit të transportit ose masave të vendosura, personat e autorizuar për kontroll kanë të drejtë të ndalojnë vazhdimin e operacionit të transportit, duke larguar mjetin nga trafiku dhe, për llogari të transportuesit, vendosin ose parkojnë mjetin në një vend të përshtatshëm e të sigurt.

3. Masat e marra nga personi i autorizuar për kontroll, sipas pikës 2 të këtij neni, përbëjnë masa urgjente dhe, si të tilla, për ato veprohet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Nëse mjete pëson dëmtime nga një aksident, personat e autorizuar për kontroll, pas kryerjes së inspektimit, tërheqin certifikatën e miratimit për mjetin që transporton disa mallra të rrezikshme, sipas nenit 12 të këtij ligji, dhe ia dorëzojnë personit juridik të autorizuar që e ka lëshuar, si dhe njoftojnë ministrinë.

5. Nëse një organ tjetër, gjatë vëzhgimit të mallrave të rrezikshme, ka konstatuar mangësi, që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit, ai njofton organet e shërbimit të kontrollit në rrugë dhe jep informacion për mjetin dhe mallrat e rrezikshme.

#### Neni 41

### **Kontrollet në mjediset e subjektit pjesëmarrës në transport**

1. Personat e autorizuar për kontroll, në bashkëpunim me inspektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorët e shërbimeve përkatëse, kryejnë kontrolle në mjediset e subjekteve pjesëmarrëse në transportin e mallrave të rrezikshme, bëjnë inspektime, konsultojnë dokumentet e nevojshme dhe marrin mostra të mallrave të rrezikshme ose të ambalazhit të tyre për testim në laboratorët e akredituar, me qëllim marrjen e masave parandaluese në transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Kontrollet në mjediset e subjektit kryhen:

a) në bazë të programit të inspektimit;

b) jashtë programit të inspektimit, kur është në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Nëse personat e autorizuar për kontroll vërejnë se dispozitat e ADR-së nuk plotësohen, ata ose ndërpresin operacionet e transportit, derisa mangësitë dhe ose defektet të riparohen, ose mund të ndalojnë nisjen e dërgesës.

#### Neni 42

### **Kontrolli i dërguesit, transportuesit ose marrësit**

1. Nëse gjatë kontrollit në rrugë, personat e autorizuar për kontroll identifikojnë të meta, ata duhet të mbikëqyrin sjelljen e dërguesit, transportuesit ose marrësit të mallrave të rrezikshme ose personave të tjerë pjesëmarrës, juridikë ose fizikë, të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Subjektet janë të detyruara të lejojnë personat e autorizuar për kontroll të inspektojnë mjetin dhe t'i dorëzojnë për njohje të gjitha dokumentet që kanë lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme. Të drejtat dhe detyrimet e subjektit janë parashikuar në dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Qëllimi i kontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, është plotësimi i kërkesave të sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme nga subjektet, si dërguesi, transportuesi ose marrësi i mallrave të rrezikshme apo nga subjektet e tjera, pjesëmarrëse në transportin e mallrave të rrezikshme.

#### Neni 43

### **Hyrja e mjeteve të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë**

1. Personat e autorizuar për kontroll në pikën e kalimit të kufirit lejojnë hyrjen e një mjeti të regjistruar në një shtet tjetër, nëse nuk konstatojnë shkelje, sipas dokumentit të përmendur në pikën 3 të nenit 45 të këtij ligji.



2. Nëse gjatë kontrollit personat e autorizuar për kontroll në pikën e kalimit të kufirit konstatojnë shkelje, sipas dokumentit të përmendur në pikën 3 të nenit 45 të këtij ligji, në një mjet të regjistruar në një shtet tjetër, ndalojnë hyrjen e mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe marrin masa të tjera të përshtatshme. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë do të lejohet vetëm nëse të metat e konstatuara riparohen.

3. Personat e autorizuar për kontrollin në rrugë përjashtojnë nga qarkullimi mjetet, sipas pikës 2 të këtij neni, dhe veprojnë në përputhje me masat e parashikuara në pikën 2 të nenit 44 të këtij ligji.

4. Masat e marra nga personi i autorizuar për kontroll, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, përbëjnë masa urgjente dhe, si të tilla, për ato veprohet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

#### Neni 44

#### **Asistenca e ndërsjellë**

1. Ministria informon autoritetin kompetent të shtetit tjetër, ku mjete është i regjistruar, për shkeljet e kryera, serioze ose të përsëritura, të dispozitave të ADR-së, të cilat rrezikojnë sigurinë në transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Nëse autoriteti kompetent i një shteti tjetër kërkon të fillojë procedurat kundër transportuesit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ose nëse kërkon informacion të nevojshëm për sqarimin e rrethanave të shkeljeve në shtetin tjetër, sipas dispozitave të ADR-së, apo fillon procedurat kundër transportuesit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ministria përcakton marrjen e masave në zbatim të këtij ligji.

3. Ministria informon autoritetin kompetent të shtetit tjetër për masat e marra, sipas pikës 2 të këtij neni.

#### Neni 45

#### **Raporti vjetor**

1. Organet e kontrollit, të cilat kryejnë kontrolle në zbatim të këtij ligji, i dorëzojnë ministrisë një raport vjetor për kontrollet e kryera për vitin paraardhës deri në fund të muajit prill të vitit në vazhdim.

2. Raporti përmban të dhëna për:

a) vëllimin e përcaktuar apo të vlerësuar të mallrave të rrezikshme të transportuara në tonë ose në tonë/kilometra;

b) numrin e kontrolleve të kryera;

c) numrin e mjeteve të kontrolluara, të klasifikuara sipas shtetit të regjistrimit të mjetit, duke përfshirë mjetet e regjistruara në vend dhe në shtete të tjera;

ç) numrin dhe llojet e shkeljeve të regjistruara, në përputhje me kategorinë e rrezikut;

d) numrin dhe llojet e masave ndëshkuese të vendosura.

3. Modeli i dokumentit për identifikimin e pjesëmarrësve, lista e shkeljeve, sipas ADR-së, grupuar sipas nivelit të rrezikut, modeli i dokumentit për raportin vjetor dhe veprimet e duhura të organeve të kontrollit caktohen me udhëzim të ministrit.

4. Ministria, mbështetur mbi të dhënat, harton një raport përmbledhës vjetor, të cilin ua dërgon organeve përgjegjëse ndërkombëtare dhe Inspektoratit Qendror.

**KREU IV**  
**DISPOZITA TË VEÇANTA PËR TRANSPORTIN ME HEKURUDHË TË MALLRAVE**  
**TË RREZIKSHME**

**Neni 46**

**Llojet e trenave të lejuar, transporti i mallrave të rrezikshme si bagazh dore, bagazhet e kontrolluara apo mjetet e ngarkuara në tren**

1. Mallrat e rrezikshme transportohen vetëm me anën e trenave të mallrave, me përjashtim të:

a) mallrave të rrezikshme, të pranuar për transport, në bazë të dispozitave të RID-it, e cila përmban sasinë maksimale të lejuar dhe kushtet e veçanta të transportit në trena të ndryshëm nga trenat e mallrave;

b) mallrave të rrezikshme, që transportohen në përputhje me kushtet speciale të RID-it, si bagazh dore, i regjistruar bagazh, ose në bordin e mjetit.

2. Mallrat e rrezikshme, të ngarkuara në njësinë e transportit dhe rimorkiot, të mbartura për transport me tren, duhet të përputhen me dispozitat e ADR-së.

3. Njësitë e transportit dhe rimorkiot, si dhe përmbajtjet e tyre me mallra të rrezikshme, të ndaluara sipas dispozitave të RID-it, nuk lejohen të mbarten për transport me tren.

4. Cilido, që udhëton me tren, nuk duhet të marrë me vete mallra të rrezikshme në bagazhin e dorës ose t'i dorëzojë ato si bagazh apo në mjetin e ngarkuar në tren, nëse këto mallra nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat e RID-it.

**Neni 47**

**Detyrimet e dërguesit**

Dërguesi dorëzon mallrat e rrezikshme për transport hekurudhor, nëse plotësohen kërkesat e nenit 14 të këtij ligji dhe nëse:

a) transportuesi paraqitet me shenjat që duhet të mbartë mjeti dhe me të dhënat për mallrat e rrezikshme;

b) në përputhje me dispozitat e RID-it, në mjet dhe në paketa vendosen shenjat e paralajmërimit, mbishkrimet, shenjat dhe etiketat për rrezikun ose nëse, për këtë qëllim, dorëzohen së bashku me mallrat e rrezikshme.

**Neni 48**

**Detyrimet e mbushësit**

Përveç detyrimeve në nenin 19 të këtij ligji, mbushësi i mallrave të rrezikshme ka për detyrë të kontrollojë:

a) afatin e inspektimit të ardhshëm për vagonët-cisternë, vagonët-bateri, cisternat e çmontueshme ose të transferueshme, konteinerët-cisternë, afat i cili nuk duhet të ketë kaluar;

b) zbatimin e kërkesave të kontrollit të veçantë, në përputhje me dispozitat e RID-it, para dhe pas mbushjes së vagonëve-cisternë ose konteinerëve-cisternë me gaz të lëngshëm.

**Neni 49**

**Detyrimet e transportuesit**

Përveç detyrimeve të nenit 15 të këtij ligji, transportuesi gjatë transportit duhet shpejt dhe pa kufizim të vërë në dispozicion të administruesit të infrastrukturës hekurudhore informacione për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me dispozitat e RID-it.



## Neni 50

### **Detyrimet e administruesit të infrastrukturës hekurudhore**

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore duhet:
  - a) të përgatisë plane për emergjencën e brendshme për stacionet hekurudhore, në përputhje me dispozitat e RID-it;
  - b) të sigurohet që të ketë në çdo moment një akses të menjëhershëm e pa kufizim për informacionet vijuese:
    - i) plan-formimin e trenave, duke treguar numrin dhe kategorinë e vagonëve të ngarkuar me mallra të rrezikshme dhe pozicionin e tyre në tren;
    - ii) numrat UN të mallrave të rrezikshme të ngarkuara në ose mbi secilin vagon ose, nëse janë ngarkuar vetëm mallrat e rrezikshme të ambalazuara në sasi të kufizuara, në përputhje me dispozitat e RID-it, ky informacion tregon prezencën e tyre, duke shënuar vagonin, në përputhje me dispozitat e RID-it.
2. Mënyrat e transmetimit të këtyre të dhënave përcaktohen në rregulloret e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore.
3. Të dhënat e përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni janë në dispozicion vetëm për ato shërbime ose agjenci, të cilat kanë kërkesa të njëjta e të nevojshme në lidhje me sigurinë ose ndërhyrjen e shërbimeve emergjente.

## KREU V

### **KOMPETENCAT E INSPEKTIMIT DHE ORGANET E TJERA MBIKËQYRËSE**

## Neni 51

### **Mbikëqyrja për zbatimin e ligjit**

Mbikëqyrja administrative dhe inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij kryhet nga ministria, ministria e përgjegjëse për çështjet e brendshme, ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, inspektorati shtetëror i ministrive të sipërpërmendura, Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimi, Agjencia Kombëtare Bërthamore dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar.

## Neni 52

### **Mbikëqyrja inspektuese**

1. Mbikëqyrja inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara për transportin e substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore kryhet, përkatësisht, nga inspektorët e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore.
2. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, inspektori përveç të drejtave të parashikuara në dispozita e ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
  - a) të monitorojë zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve të përmendura në nenin 5 të këtij ligji, në rast të ndonjë aksidenti ose incidenti gjatë transportit apo gjatë kalimit transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - b) të monitorojë përgatitjen për ambalazhimin (paketimin), ngarkimin, shkarkimin dhe transportin dhe, nëse konstaton parregullsi, të urdhërojë riparimin brenda një afati të caktuar të të metave ose, në rastin e shkeljeve serioze të sigurisë, të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë;



c) të ndalojë vazhdimin e operacionit, nëse konstaton se për këtë operacion nuk ka autorizim dhe dokumentacionin e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, nëse transporti nuk monitorohet nga shoqërues të trajnuar ose nëse transporti nuk përmbush zbatimin e masave të sigurisë;

ç) të kontrollojë dokumentet për transport, etiketimin dhe pajisjet e mjeteve, itinerarin e udhëtimit, të vendosur për shmangien e parregullsive ose, gjatë kontrollit të personave, mjeteve dhe burimeve fikse të defekteve të rrezatimit, njëkohësisht, të ndalojë vazhdimin e transportit, në rast se ky operacion shkakton dëme në njerëz dhe në mjedis.

3. Mbikëqyrja në zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara për transportin e substancave ose lëndëve plasëse kryhet nga ministria për çështjet e brendshme.

4. Kur mallrat e rrezikshme hyjnë në ose nga pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë, procedurat për miratimin e lejimit dhe përdorimit të mallrave të rrezikshme, që i përkasin mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryhen nga organet doganore në pikën e kalimit të kufirit. Në këtë rast, përgjegjësia është e administratës doganore.

5. Monitorimi në zbatim të këtij ligji dhe akteve nënligjore për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë kryhet nga organet e kontrollit në rrugë, me përjashtim të dispozitave që lidhen me kushtet e prodhimit dhe testimit të ambalazhit.

6. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara për transportin e mallrave të rrezikshme me hekurudhë kryhet nga inspektorët përgjegjës të transportit hekurudhor të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

#### Neni 53

### **Komiteti Ndërmintor për Transportin e Mallrave të Rrezikshme**

1. Për qëllime të efektivitetit në zbatimin e këtij ligji, për menaxhimin e mallrave të rrezikshme dhe rritjen në nivel të konsiderueshëm të koordinimit ndërmintor për transportin e mallrave të rrezikshme, krijohet Komiteti Ndërmintor për Transportin e Mallrave të Rrezikshme. Funksionimi dhe detyrat e këtij komiteti miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë, ku kryetar është zëvendësministri që mbulon çështjet e transportit në ministri dhe tetë anëtarët e tjerë propozohen nga ministri, Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore.

3. Komiteti, për çështje të caktuara të transportit të mallrave të rrezikshme, ka të drejtë të thërrasë ekspertë të tjerë.

4. Ministri cakton një sekretari që siguron mbarëvajtjen e punës së komitetit, e cila përbëhet nga katër anëtarë të drejtorive që mbulojnë operimin, sigurinë dhe shërbimet e kontrollit në rrugë, në transportin me rrugë dhe një anëtar që mbulon fushën e transportit hekurudhor.

5. Anëtarët e komitetit përfitojnë të drejtën e shpërblimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 54

### **Ruajta e regjistrimeve**

1. Për sigurinë në transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për zbatimin e këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor mban të dhënat për drejtuesit e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme me rrugë.



2. Për sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme, në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për zbatimin e këtij ligji, ministria mban të dhënat për këshilltarët e sigurisë, të emëruar nga personat fizikë e juridikë.

3. Në regjistrin për dënimet e drejtuesve të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme përfshihen të dhënat për:

- a) numrin e dënimeve;
- b) datën e lëshimit të certifikatës;
- c) emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes së drejtuesit, të cilit i është lëshuar certifikata;
- ç) vlefshmërinë e trajnimit bazë dhe llojin e vlefshmërisë për çdo trajnim të specializuar;
- d) datën e përfundimit pas zgjatjes së trajnimit bazë dhe llojin e datën e vlefshmërisë për çdo trajnim të specializuar.

4. Në regjistrin e personave juridikë ose fizikë, të cilët kanë të emëruar këshilltarë të sigurisë, përfshihen të dhëna për:

- a) emrin e personit juridik ose fizik;
- b) vendqëndrimin/selinë e personit juridik ose fizik;
- c) emrin dhe mbiemrin e këshilltarit të sigurisë;
- ç) datën e emërimit si këshilltar.

#### Neni 55

#### **Mbledhja e të dhënave**

1. Institucioni i autorizuar për trajnimin dhe vlerësimin profesional të drejtuesve të mjeteve për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë është i detyruar të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor një informacion me të dhënat për trajnimin dhe vlerësimin profesional të drejtuesve të mjeteve, brenda 15 ditëve nga data përfundimit të vlerësimit.

2. Të dhënat për personat, që janë caktuar këshilltarë të sigurisë, merren përmes informacionit të subjekteve, në bazë të pikës 2 të nenit 28 të këtij ligji.

3. Ministria, në bazë të ekzaminimit të këshilltarëve, krijon dhe menaxhon regjistrin kryesor.

4. Personi, i cili administron mbledhjen e të dhënave, i dorëzon, me kërkesë të organit përgjegjës për mbikëqyrjen, të dhënat e përmendura në nenin 54 të këtij ligji, në përputhje me këtë ligj.

5. Për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave nga regjistrat e përmendur në nenin 54 të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

#### Neni 56

#### **Kontrolli i brendshëm**

Subjektet, që kryejnë veprimtari në transportin e mallrave të rrezikshme, realizojnë kontrollin e tyre të brendshëm për zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, nëpërmjet organizmave të tyre të kontrollit, sipas detyrave të përcaktuara në aktet themeluese, në statute dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

KREU VI  
DISPOZITA PËR SANKSIONET

Neni 57  
**Kundërvajtjet administrative**

A. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, të kryera nga personi juridik, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Mospërmbushja e kushteve për përdorimin e ambalazhit nga dërguesi, transportuesi dhe marrësi i mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të nenit 7 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Mospërmbushja e kushteve për prodhimin e ambalazhit nga prodhuesi, sipas përcaktimeve të nenit 8 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 200 000 lekë.

3. Mospërmbushja e kushteve për kontrollin e kampioneve/mostrave dhe për miratimin e ambalazheve me markën e miratimit në kundërshtim me ADR-në ose RID-in, sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 200 000 lekë.

4. Mospërmbushja e kushteve të mjetit, i cili nuk është prodhuar dhe nuk është i pajisur sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

5. Mosplotësimi i kërkesave në përdorimin e një mjeti, i cili duhet të jetë i inspektuar (kontrolluar) dhe i pajisur me certifikatën e miratimit ADR në transportin e mallrave të rrezikshme nga përdoruesi ose pronari i mjetit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

6. Vendosja e shenjave paralajmëruese për mallra të rrezikshme në një paketë apo mjet, i cili nuk përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

7. Mospërmbushja e kërkesave nga dërguesi para transportimit të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

8. Mosplotësimi i kërkesave nga dërguesi në dorëzimin e dokumenteve mbështetëse dhe autorizimin për drejtuesin e mjetit ose personin që kryen transportin, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

9. Mosplotësimi i kushteve nga transportuesi, sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

10. Mosplotësimi i kushteve nga marrësi i mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

11. Mosplotësimi i kushteve nga pronari ose operatori i konteinerit-cisternë ose cisternës së transferueshme, sipas përcaktimit të nenit 20 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

12. Mosinformimi i Qendrës Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile nga transportuesi për humbjen e mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

13. Mospërmbushja e detyrimeve për masat e duhura që duhet të ndërmerret transportuesi, në rast derdhjeje apo rrjedhjeje të mallrave të rrezikshme, duke i grumbulluar, hequr ose vendosur në një vend të caktuar, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

14. Mospërmbushja e kushtit për moskontraktimin e një personi juridik apo fizik, të autorizuar për largimin ose vendosjen në një vend të duhur të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

15. Mospërmbushja e kushteve nga transportuesi për pajisjen me autorizim apo autorizim të veçantë, ose kur transporti i mallrave të rrezikshme kryhet në kundërshtim me kushtet që mund të



jenë vendosur në autorizim, sipas përcaktimit të neneve 23, 25 dhe 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

16. Mospërmbushja e kushteve për mosçaktimin e këshilltarit të sigurisë ose mosdhënia e të dhënave për ndonjë ndryshim të mundshëm të tij tek institucionet përgjegjëse dhe personat juridikë, sipas përcaktimit të neneve 28 dhe 52 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

17. Mosplotësimi i kushteve për një këshilltar sigurie, i cili nuk përmbush detyrimin, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 28 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

18. Mosplotësimi i kushteve për një këshilltar sigurie, i cili nuk përmbush detyrimet, sipas përcaktimit të nenit 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

19. Mospërmbushja e kushteve nga personi ose personat pjesëmarrës në transportin e mallrave të rrezikshme, të cilët nuk janë të kualifikuar, sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

20. Mospërmbushja e kushteve nga transportuesi për mjetin dhe drejtuesin e mjetit nga transportuesi, sipas përcaktimit të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

21. Mospërmbushja e kushteve për veprimet e dërguesit, sipas përcaktimit të nenit 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

22. Mosplotësimi i kushtit për lejimin e një drejtuesi të mjetit, i cili nuk është i pajisur me një certifikatë të vlefshme kualifikimi për drejtimin e një mjeti në transportin e mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimeve të neneve 35 dhe 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

23. Mosplotësimi i kushteve, sipas nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

24. Mosplotësimi i detyrimeve për t'u ofruar personave të autorizuar për kontroll pasqyrën e dokumenteve shoqëruese ose nuk u mundëson inspektimin e pajisjeve shtesë ose mallrave të rrezikshme, përkatësisht, marrjen e mostrës së mallrave të rrezikshme për analizë, si dhe nuk përkujdeset për kryerjen e inspektimit të mjetit në vend ose në vendin e duhur, sipas përcaktimit të nenit 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

25. Mosplotësimi i detyrimit nga transportuesi për zbatimin e masës për ndalimin ose pezullimin e vazhdimin të operacionit të transportit, sipas përcaktimit të nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

26. Mosplotësimi i detyrimeve për t'u ofruar personave të autorizuar për kontroll dokumentet e nevojshme ose lehtësira në marrjen e mostrave për analiza të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

27. Mosplotësimi i detyrimeve nga personi juridik në lejimin e zbatimit të procedurave të kontrollit për inspektimin e mjetit dhe të gjithë dokumentacionit, në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit në pikat 1 dhe 2 të nenit 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

28. Mospërmbushja e kushteve në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të nenit 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

29. Mosplotësimi i kushteve nga dërguesi para fillimit të transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimit të nenit 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

30. Mospërmbushja e detyrimeve nga transportuesi hekurudhor, sipas përcaktimit të nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

31. Mospërmbushja e detyrimeve të administruesit të infrastrukturës hekurudhore, sipas përcaktimit në pikat 1 dhe 2 të nenit 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë.

32. Mospërbushja e detyrimeve të institucioneve, ministrisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për mosdhënien e informacioneve për drejtuesit e mjeteve dhe këshilltarët e sigurisë, të trajnuar, sipas përcaktimit në pikat 1 dhe 2 të nenit 54 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

33. Mospërbushja e detyrimeve për kontrollin e brendshëm nga subjekti, sipas përcaktimit të nenit 56 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

B. Shkeljet e parashikuara në shkronjën “A” të këtij neni, me përjashtim të pikave 3 dhe 28, të kryera nga një subjekt fizik, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

C. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Mospërbushja e detyrimeve nga marrësi për pranimin e ngarkesave të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

2. Mospërbushja e detyrimeve nga ngarkuesi dhe shkarkuesi sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

3. Mospërbushja e detyrimeve nga ambalazhuesi (paketuesi) për rregullat në paketim, etiketat, shënimet për rreziqet dhe masat e tjera të sigurisë, sipas përcaktimit të nenit 18 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

4. Mospërbushja e detyrimeve nga mbushësi në plotësimin e rregullave të sigurisë, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

5. Mospërbushja e detyrimeve të këshilltarit të sigurisë për kualifikimin ose moszotërimi i një certifikate të vlefshme kualifikimi, sipas përcaktimeve të nenit 28 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

6. Mosplotësimi i detyrimeve të këshilltarit të sigurisë në përbushjen e detyrave të tij, sipas përcaktimeve të neneve 29 dhe 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

7. Mospërbushja e detyrimeve nga personat e përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme për kualifikimin e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

8. Mosplotësimi i detyrimeve nga drejtuesi i mjetit për kualifikimin dhe njohjen me mallrat e rrezikshme që do të transportojë, sipas përcaktimeve të nenit 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

9. Mospërbushja e detyrimeve të drejtuesit të mjetit mbi masat e sigurisë që duhet të marrë drejtuesi i mjetit gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe transportit të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimeve të nenit 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

10. Mosplotësimi i detyrimeve të drejtuesit të mjetit për pajisjen me certifikatën e kualifikimit, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

11. Mospërbushja e detyrimeve të drejtuesit të mjetit për krijimin e lehtësive për marrjen e mostrave, paraqitjen e dokumenteve, dokumentin e kontrollit dhe inspektimin e mjetit, sipas përcaktimeve në pikat 2, 3, 5 dhe 6 të nenit 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.

12. Mospërbushja e detyrimeve të drejtuesit të mjetit për pezullimin ose ndalimin e vazhdimin të operacionit të transportit, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

13. Mospërbushja e detyrimeve nga udhëtari në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas përcaktimeve të nenit 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë.



14. Mospërbushja e detyrimeve nga mbushësi i lëndëve të rrezikshme, sipas përcaktimeve të nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

Neni 58  
**Vjelja e gjobave**

Të ardhurat, që burojnë nga vjelja e gjobave, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 59  
**Procedurat e ankimit**

Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit, sipas legjislacionit në fuqi, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VII  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 60  
**Afatet e fundit në zbatimin e dispozitave të këtij ligji**

1. Institucionet e caktuara për dhënien e miratimit të përdorimit për ambalazhin duhet që, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përbushin kushtet e nenit 9 të këtij ligji.

2. Subjektet e përmendura në pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të caktojnë së paku një këshilltar sigurie.

3. Udhëzimi për inspektimin e mjeteve dhe përpunimin e dokumentacionit për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR për mjetet e transportit të mallrave të rrezikshme do të mbetet në fuqi gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Udhëzimi për trajnimin, testimin dhe pajisjen e drejtuesve të mjeteve dhe mjeteve me certifikatën e kualifikimit për transportin e mallrave të rrezikshme do të vazhdojë të mbetet në fuqi gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Subjektet e angazhuara në transportin e mallrave të rrezikshme, në bazë të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar do të vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

6. Subjektet, të cilat nuk rregullojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, ndërpresin veprimtarinë e tyre, e cila përcaktohet me vendim të ministrit.

7. Autorizimet, certifikatat dhe dokumentet e tjera, të lëshuara për personat juridikë dhe fizikë, në përputhje me legjislacionin që ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në daljen e dokumenteve përkatëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji e akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. Autoritetet përgjegjëse mbledhin të dhënat, sipas nenit 55 të këtij ligji, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 61  
**Marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe**

Ministri, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji, mund të nënshkruajë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me autoritetet kompetente të shteteve, palë kontraktuese, për lejinin e transportuesve me seli në shtetet, me të cilat ka një marrëveshje të tillë në fuqi, për kryerjen e disa operacioneve të përkohshme të transportit ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme, me kusht që siguria në transport të mos cenohet.

Neni 62

**Përkthimi dhe publikimi i marrëveshjeve**

1. Ministri autorizon përkthimin në gjuhën shqipe dhe publikimin e marrëveshjeve, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 5 të këtij ligji, marrëveshja europiane “Për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë” (ADR) dhe rregullores për transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (RID).

2. Përkthimi dhe publikimi i marrëveshjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, do të kryhet periodikisht sa herë rishqyrtohen e ribotohen anekset A dhe B për transportin me rrugë dhe aneksi C për transportin me hekurudhë.

Neni 63

**Hartimi i akteve nënligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian**

Me qëllim përafrimin e përditësimit të legjislacionit të transportit të mallrave të rrezikshme me direktivat e rregulloret e Komunitetit Europian, si dhe me marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji, ministri, në bashkëpunim ose jo me ministrat e tjerë përkatës, sipas rastit, nxjerr udhëzime.

Neni 64

**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr vendimet në zbatim të pikës 8 të nenit 9, pikës 5 të nenit 31, pikës 4 të nenit 32, pikës 2 të nenit 38 dhe pikës 1 të nenit 53 të këtij ligji.

2. Ministri, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr udhëzimet, në zbatim të pikës 3 të nenit 13, pikës 2 të nenit 29, pikave 1 dhe 2 të nenit 31, pikës 3 të nenit 32, pikës 2 të nenit 34, pikave 5 dhe 6 të nenit 37, pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 38, pikës 5 të nenit 39 dhe pikës 3 të nenit 45 të këtij ligji.

3. Ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerrin udhëzimet në zbatim të pikës 2 të nenit 31 dhe pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

4. Ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Brendshëm dhe Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerrin udhëzimin në zbatim të pikave 3 dhe 4 të nenit 36 të këtij ligji.

Neni 65

**Shfuqizimet**

Kreu V i ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 66

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7876, datë 26.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



**VENDIM  
Nr. 50/2012**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË  
KUVENDIT “PËR HETIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE  
PËR ZBULIMIN, IDENTIFIKIMIN, PËRBALLIMIN, NEUTRALIZIMIN, PENGIMIN DHE  
NDËSHKIMIN E VEPRIMIT TË ORGANIZUAR KRIMINAL PËR DHUNIMIN E  
INSTITUCIONEVE DHE PËRMBYSJEN E RENDIT KUSHTETUES  
NË DATËN 21 JANAR 2011”**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011” zgjatet deri në përfundim të mandatit të Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miraturar në datën 7.12.2012

**VENDIM  
Nr. 51/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 99, DATË 26.5.2011 “PËR  
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR ÇËSHTJET GJINORE DHE MBROJTJEN E  
FËMIJËVE NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR  
PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË”**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1, 19 pika 2 dhe 21 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me kryetarët e Grupeve Parlamentare të Partisë Demokratike, të Partisë Socialiste dhe të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 99, datë 26.5.2011 “Për ngritjen e nënkomisionit për çështjet gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve në përbërje të Komisionit të Përherëshëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:



I. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:

1. Lajla Pernaska (PD) - kryetare
2. Albana Vokshi (PD) - anëtare
3. Kosta Barka (PD) - anëtar
4. Eglantina Gjermani (PS) - anëtare
5. Klodiana Spahiu (PS) - anëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 13.12.2012

**VENDIM**  
**Nr. 52/2012**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR  
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhet kjo shtesë:

- I. Deputetja Paulina Hoti caktohet anëtare në Komisionin për Politikën e Jashtme.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 13.12.2012

**VENDIM**  
**Nr. 53/2012**

**PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH “PËR HETIMIN E  
VEPRIMTARISË SË ORGANEVE SHTETËRORE MBI LËVIZJEN E POPULLSISË NË  
DISA NJËSI VENDORE TË QARKUT TË KUKËSIT GJATË PERIUdhËS QERSHOR-  
NËNTOR 2012”**

Në mbështetje të nenit 78 pika 2 të Kushtetutës, nenit 4 pika 1 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, të nenit 25 të



Rregullores së Kuvendit, si dhe vendimeve nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për hetimin e veprimtarisë së organeve shtetërore mbi lëvizjen e popullsisë në disa njësi vendore të qarkut të Kukësit gjatë periudhës qershor-nëntor 2012”, për shkak se objekti i punës së këtij komisioni, i propozuar në këtë kërkesë, është në kundërshtim me nenin 77 pika 2 të Kushtetutës, si dhe vendimet nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratur në datën 20.12.2012

**VENDIM  
Nr. 54/2012**

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE  
TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zonja Entela Shehaj emërohet anëtare e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratur në datën 20.12.2012

**UDHËZIM**  
**Nr. 622, datë 30.11.2012**

**PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE  
PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin 86/2012, inspektori i përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

**UDHËZON:**

1. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ngritjen dhe funksionimin e autoriteteve përgjegjëse (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore, si më poshtë:

a) Ngritja e autoriteteve përgjegjëse të bëhet bazuar në nenin 41 pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

b) Emërimi i autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, si strukturë e veçantë, e cila do të mbajë në vijimësi marrëdhëniet dhe kontaktet me ILDKPKI-në, bëhet me urdhër nga titullari i institucionit.

c) Autoriteti përgjegjës duhet të jetë pjesë e drejtorisë/vektorit të burimeve njerëzore. Vetëm në mungesë të kësaj strukture, eprori mund të emërojë si autoritet përgjegjës punonjës të tjerë të institucionit me formim jurist.

d) Pozicioni i nëpunësit/sve që do të kryejë detyrat e autoritetit përgjegjës përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit dhe në përshkrimin e vendit të punës.

e) Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjëse, në zbatim të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, zyrtari, i cili ka kompetencë ligjore për emerimin, lëvizjen apo largimin e AP-së, duhet të njoftojë paraprakisht inspektorin e përgjithshëm të ILDKPKI-së, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

f) Pas marrjes së njoftimit për lëvizjen apo largimin e AP-së, ILDKPKI-ja shqyrton rastin dhe jep udhëzimet përkatëse lidhur me çështjen brenda një afati kohor 15-ditor.

**2. Funksionimi dhe detyrat e autoriteteve përgjegjëse në drejtim të rolit parandalues**

Autoriteti ose struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41 pika 2 të tij, në përputhje me masën, mënyrën dhe radhën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, në këtë udhëzim, si dhe/ose në aktet nënligjore e rregulloret e brendshme të institucionit publik, me qëllim parandalimin e rasteve të konfliktit të interesave, në mënyrë aktive dhe në emër të institucionit publik përkatës, kryen këto detyra:

**2.1 Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat private të zyrtareve.**

a) Shpërndan dhe mbledh autorizimet e lëshuar nga zyrtarët në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005; autorizimi sipas formatit të miratuar nga inspektori i përgjithshëm, është i detyrueshëm për t’u plotësuar nga çdo zyrtar, i cili kryen një funksion publik dhe nënshkruhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës.

b) Në emër të institucionit publik, mbledh të dhëna personale për zyrtarin, kudo që ato janë të regjistruara në regjistrat publikë, të cilat lidhen me interesat private që mund të krijojnë ose duket sikur krijojnë konflikt interesi me funksionin publik apo detyrat që ushtron zyrtari. Mbledhja e këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



2.2 Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si dhe ndryshimet në rregulloret e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit, në përputhje me ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, si dhe udhëzimeve të ILDKPKI-së.

3. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse për konstatimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave

Autoriteti përgjegjës, në emër të institucionit, kryen verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjithë regjistrat publikë apo institucione të tjera, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejtë deri te titullari i institucionit:

a) Autoriteti përgjegjës pranon informacion të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.

b) Në bazë të informacionit të grumbulluar, autoriteti përgjegjës, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, vlerëson nëse rasti konkret përbën konflikt interesi, duke analizuar njëkohësisht dhe rolin dhe kompetencat e zyrtarit në procesin vendimmarrës.

c) Verifikon dhe vlerëson nëse nga situata e konstatuar në kushte të konfliktit të interesit kanë ardhur pasoja.

d) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

e) Plotëson dhe administron regjistrin e konfliktit rast për rast të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:

i) identitetin e zyrtarit;

ii) interesat privatë të tij, të cilët janë bërë shkak për një konflikt interesi;

iii) thelbin e konfliktit;

iv) palët e interesuara;

v) burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe e verifikimit të tyre;

vi) vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat;

f) Mbështet eprorin, sipas rastit, për marrjen e masave disiplinore dhe raporton rastin në ILDKPKI për ndjekje të mëtejshme.

4. Rregullimi i pasojave juridike, pavlefshmeria e akteve/kontratave administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesave

4.1 Autoriteti përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, e cila trajton çështjet juridike:

a) Merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesit;

b) Siguron transparencën me publikun lidhur me vendimmarrjet e kryera nga institucioni përkatës dhe zbatimin me korrektësi të ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

4.2 Shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI-ja, për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, si dhe përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave.

4.3 Propozon me shkrim, që nëpërmjet organit kompetent (eprorit/institucionit epror) të revokohen/shfuqizohen aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesave.

4.4 Në rastet e konstatimit të pavlefshmërisë së një akti/kontrate administrative të institucionit publik, sipas përkufizimit të këtij termi në Kodin e Procedurave Administrative, si pasojë e nxjerrjes së tyre në kushtet e konfliktit të interesave (faktik apo në dukje), autoriteti

përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përkatëse, në zbatim të nenit 40/1 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim:

- a) I propozon eprorit/organit kompetent fillimin e procedurave të dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit;
- b) Propozon të ndërmerren procedurat për kalimin e barrës së dëmshpërblimit te ky zyrtar;
- c) Ndihmon që të përgatitet padi në gjykatë për vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;
- d) Propozon të bëhet kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykohet se shkelja e kryer nga ai përbën veprë penale.

Këto masa të sipërcituara mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit ose për moszbatimin e detyrimeve për shmangien e konfliktit të interesave, të përcaktuara në ligj.

#### 5. Roli këshillues dhe trajnues i autoriteteve përgjegjëse

a) Autoriteti përgjegjës i sugjeron zyrtarëve dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesit rast për rast ose të vazhdueshëm (faktik, në dukje dhe i mundshëm).

b) Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave nga ILDKPKI-ja në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

c) Përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave.

d) Merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare, që lidhen me konfliktin e interesit.

#### 6. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse në procesin e deklarimit:

a) Autoriteti përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, duhet të përgatitë listën e zyrtarëve, të cilët në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave private dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI;

b) Shpërndan formularët e deklaratave të interesave private sipas llojit (*para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni*) për plotësim zyrtarëve, të cilët mbartin detyrim për deklarim;

c) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private;

d) Informon zyrtarët lidhur me sanksionet në rast refuzimi për plotësim të deklaratës, në rast mosplotësimi brenda afatit, si dhe në rastin e deklarimeve të rreme;

e) Jep asistencë nëse kërkohet nga ana e zyrtarëve në plotësimin e deklaratave;

f) Mbledh deklaratat e plotësuara nga zyrtarët (subjekte të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe i dërgon pranë ILDKPKI-së.

g) Përgatit jo më vonë se 31 janari i vitit pasardhës, raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer dhe e dërgon në ILDKPKI.

#### 7. Raportimi vjetor mbi veprimtarinë e autoriteteve përgjegjëse

Në zbatim të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, autoritetet përgjegjëse i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e



lidhura me deklarinimin periodik.

Raporti vjetor duhet të përmbajë:

a) Për procesin e deklarimit të interesave private periodike:

i) njoftimin, dhënien e konsulencës dhe dorëzimit të deklaratave të interesave private nga zyrtarët, si dhe respektimi i afateve ligjore nga ana e tyre;

ii) rakordimi i listës së zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarimin e interesave private;

iii) evidentimi i rasteve të mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private;

iv) evidentimi i marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave;

i) plotësimin e autorizimit për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar;

ii) identifikimin, regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave;

iii) raste të verifikuara dhe të kontrolluara për konflikt interesi;

iv) raste të trajtuara dhe të zgjidhura të konfliktit të interesave;

v) raste të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori.

8. Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave

a) Autoriteti përgjegjës duhet të respektojë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tij (edhe pas largimit të zyrtarit nga funksioni), parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

b) Në rastet kur konstatohet shkelje e detyrimeve ligjore nga kjo strukturë, inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së i propozon titullarit të institucionit masë disiplinore në zbatim të pikës 3 të nenit 45 të ligjit nr. 9367, si dhe ndërmer procedurat për vendosjen e masave administrative me gjobë në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

9. Kryerja e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave nga ana e autoriteteve përgjegjëse në funksion të parandalimit të konfliktit të interesave, duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.

Bashkëlidhur këtij udhëzimi gjenden dokumentet e unifikuara, si më poshtë:

a) Autorizimi sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 (aneksi nr. 1);

b) Deklarimi rast pas rasti i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike (aneksi nr. 2);

c) Regjistri vjetor i evidentimit dhe i zgjidhjes së konfliktit të interesave (aneksi nr. 3);

d) Modeli i urdhrimit për ngritjen e AP-së (aneksi nr. 4);

e) Administrimi i dokumentacionit nga AP-ja (aneksi nr. 5).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM  
Adriatik Llalla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(emërtimi i institucionit)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

(qyteti) më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

**AUTORIZIM**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

me funksion \_\_\_\_\_  
(emërtimi i funksionit dhe i institucionit publik)

në datën \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10 pika 2 dhe nenit 41 pika 2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, autorizoj institucionin

(emërtimi i institucionit publik ose i institucionit epror sipas pikës 10 të nenit 3 të ligjit nr. 9367) që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave private, të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave personale, të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të këtij ligji.

Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mia private, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet ose personat e autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t’u nxjerrë pengesë personave konkretë, që posedojnë origjinalin ose kopjen e njehsuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mia private.

Në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, që vihet në dijeni për të dhënat personale të autorizuesit, detyrohet të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

AUTORIZUESI

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

TITULLARI I INSTITUCIONIT  
(OSE I INSTITUCIONIT EPROR)

(emër, mbiemër, nënshkrimi)  
(vula e institucionit)



**DEKLARIM**  
**RAST PAS RASTI I INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT**  
**NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE**

Kush mbart detyrimin për deklaram rast për rast të interesave private:

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Llojet e deklaramit:

1. Vetëdeklaram paraprak rast për rast të ekzistencës së interesave private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.

2. Deklaram rast për rast të interesave private të një zyrtari, kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

Të dhëna personale:

emri – atësia – mbiemri – funksioni – institucioni

Lloji i deklaramit: (vendos X në kutizën për llojin e deklaramit)

Me kërkesë të \_\_\_\_\_

Vetëdeklaram

Vërtetoh se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

1. Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2. Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3. Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaramës \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri, nënshkrimi



Datë \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

Republika e Shqipërisë

Institucioni \_\_\_\_\_

**REGJISTRI VJETOR I EVIDENTIMIT DHE ZGJIDHJES SË RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Funksioni	Data e evidentimit	Përshkrimi i konfliktit të interesit	Burimi i të dhënave dhe verifikimi	Mënyra dhe data e zgjidhjes së konfliktit	Shënime
1.									
2.									
3.									
4.									
5.									
6.									
7.									
8.									
9.									
10.									
11.									
12.									

Shënim. Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në të cilën duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarinimin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të autoritetit përgjegjës. Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoratin e Lartë brenda datës 31 janar të çdo viti.

Autoriteti përgjegjës

\_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*(emërtimi i institucionit)*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**URDHËR**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**PËR**

**NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

Në mbështetje të nenit 41 pika 2 germa “b” dhe nenit 42 pika 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe ligjit..... *(ligji përkatës i institucionit)*,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
2. Caktimin e:
  - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ *(drejtor i drejtorisë/njesisë së burimeve njerëzore ; ose përgjegjës personeli; ose juristin e institucionit etj.)*;
  - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ *(specifiko)*;
  - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ *(specifiko)*;si anëtarë të njesisë autoritet përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
3. Drejtuesi i njesisë autoritet përgjegjës caktohet z/znj. \_\_\_\_\_. Drejtuesi i njesisë bën ndarjen e punës mes anëtarëve.
4. Njësia e ngritur në pikën 1 të këtij urdhri si autoritet përgjegjës do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I INSTITUCIONIT

\_\_\_\_\_  
*(emër, mbiemër, nënshkrimi)*

## ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT NGA AUTORITETI PËRGJEGJËSE

Për administrimin e këtij dokumentacioni autoriteti përgjegjës duhet të mbajë disa dosje:

1. Dosja nr. 1 me titull “Për aktet ligjore dhe nënligjore” duhet të përmbajë:
  - Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
  - Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
  - Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;
  - Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
  - Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
  - Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
  - Ligjet organike në varësi të veprimtarisë së institucionit publik;
  - Komentaret ligjorë të ILDKPKI-së;
  - Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI-së ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
  - Botime të tjera të ILDKPKI-së.
2. Dosja nr. 2, me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave”, duhet të përmbajë:
  - a) Regjistri i konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
  - b) Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarin rast për rast të interesave;
  - c) Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
  - d) Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
  - e) Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.
3. Dosja nr. 3 me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që bartin detyrimin për ILDKPKI-në”, duhet të përmbajë:
  - Regjistrin themeltar alfabetik me emrat dhe funksionet e zyrtarëve, që deklarojnë në ILDKPKI;
  - Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarin dhe konfirmimet e tyre;
  - Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
  - Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
  - Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

**Kujdes!** Në rast largimi nga detyra e autoritetit përgjegjës, zyrtari/zyrtarët duhet të bëjnë dorëzimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm me procesverbal dhe inventar të detajuar, pranë drejtorisë/ njësisë së burimeve njerëzore, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/zyrtarëve të rinj që marrin detyrën e AP-së.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.1.2013  
Doli nga shtypi më 3.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 70 lekë